

BIBLIOTEKA

92  
P 88



ZEKO BRAHO  
**MARIGO POSIO**

92

P88

ZEKO BRAHO

# Marigo Posio



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

**Redaktore: Elena Kadare**  
**Recensues: Zihni Haskaj**  
**Thanas Gjika**  
**Piktor: Spiro Kristo**

## K R E U I

### 1. MJEDISI ATDHETAR I VITEVE TË FËMIJËRISË DHE TË RINISË

Gruaja shqiptare në shekuj ka qenë bashkëluftëtare e burrit në luftërat që populli ynë ka bërë për pavarësi, liri e përparim shoqëror. Ajo jo vetëm që mëkoi ndjenjat e larta të një patriotizmi të kulluar, por, kur e deshi nevoja, rrëmbeu armët dhe tregoi heroizma të pashoq.

Gruaja shqiptare nuk është dalluar vetëm si luftëtare me armë e si frymëzuese për vepra të larta atdhe-dashurie të fëmijëve të saj. Ajo është shquar edhe si një veprimtare shoqërore në kohë shumë të vështira për jetën e popullit tonë, kur zakonet anadollake dhe kanuni e pengonin, madje dhe e përçmonin forcën e saj. Por ajo, me guximin që e karakterizon, ka çarë përpara nga brezi në brez derisa më në fund arriti epokën e ndritur të Partisë, e cila i siguroi asaj barazinë me burrin në të gjitha fushat e jetës. Që në nëntor të vitit 1942, duke goditur tradhtarin Mustafa Kruja, i cili, përveç të tjerash, shprehej keq për vajzat shqiptare, që kishin dalë malit në luftë për liri kundër pushtuesit fashist, shoku Enver shkruan: «Nuk e ke mësuar heroizmin e grave të Sulit? Heroizmin e Marigove kundër skllavërimit otoman? Trimërinë e gjalmëzave

të Labërisë në luftën kundër okupatorit italian më 1920».<sup>1</sup>

Një nga këto gra trimëresha e të zgjuara është Marigo Posio.<sup>2</sup>

Atdhetarja e shquar lindi në qytetin e Korçës në vitin 1878<sup>3</sup> një nga vitet më të zjarrta të historisë sonë kombëtare, viti i krijimit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Shekulli i kaluar shënoi kthesa të mëdha në jetën ekonomike, politike e kulturore për popujt e Evropës e të Ballkanit duke vënë në rend të ditës revolucionet shoqërore borgjeze e kombëtare.

Si pasojë e shturjes së marrëdhënieve të vjetra feudale dhe lindjes së formave të reja të shfrytëzimit kapitalist edhe në strukturën ekonomike e shoqërore të vendit tonë ndodhën ndryshime të rëndësishme. As sundimi feudalo-ushtarak osman, as vërshimi i mallrave të industrisë kapitaliste evropiane nuk mundën ta ndalin hyrjen e Shqipërisë në rrugën e zhvillimit kapitalist, ndonëse me ritme mjaft të ulëta.

Me shturjen e marrëdhënieve feudale dhe rritjen e shkëmbimeve të tregut, po formohej bashkësia e jetës së brendshme ekonomike, gjë që dha ndihmesë të madhe në forcimin e lidhjeve ekonomike e shoqërore midis krahinave të ndryshme të vendit dhe nxori në pah bashkësinë e interesave për luftën kundër pu-

---

1) Enver Hoxha, Vepra, vëll. I, bot. II, 1983, f. 197-198.

2) Në shkrimet ku përmendet mbiemri i kësaj familjeje vërejmë një mosqëndrueshmëri nga Posio në Pozio, Bozio, Bozo. Ne kemi parapëlqyer Posio, sepse gazeta që ajo drejtoi dhe kartëvizita që na ka rënë në dorë si dhe mjaft shkrime të saj nënshkruhen me Posio.

3) Parapëlqyem si vit lindjeje të Marigosë 1878-tën, se në disa shkrime, përfshirë dhe Fjalorin Enciklopedik Shqiptar, shënojnë këtë datë, por nuk mungojnë dhe të dhëna të tjera, që shënojnë vitin 1876, ndërsa në bazë të librit të gjendjes civile të vitit 1930 të lagjes «Ismail Efendi», Tiranë (libri 1, fleta 173) si datëlindje shënojnë 12 shkurtin e vitit 1882. Pra problemi mbetet ende i pazgjidhur përfundimisht.

shtuesit osman. Një nga qytetet shqiptare ku u ndie herët kjo dukuri ishte Korça.

Zhvillimi i ekonomisë së mallrave, i shoqëruar dhe me vërshimin gjithnjë e më të madh të prodhimit të huaj industrial çuan në rrënimin e prodhimit të vogël zejtar, lindjen e punishteve të manufakturës dhe lidhjen e ekonomisë bujqësore me tregun duke futur dhe pronësinë e tokës në sferën e marrëdhënieve të tregut. Për pasojë, në radhët e klasave dhe të shtresave shoqërore nisi të bëhej dhe diferencimi duke lindur klasat e reja, siç ishin proletariati dhe borgjezia, të cilat filluan të luanin një rol gjithnjë në rritje.

Që nga viti 1842 deri në vitin 1888 numri i punishteve zejtare dhe i dyqaneve të tregtisë në Korçë u rrit nga 480 në 760.<sup>1</sup> Numri i dyqaneve u rrit shumë dhe në 160 fshatrat e Korçës kishte 1110 dyqane.<sup>2</sup> Gjatë viteve 1870-1890, si në disa vise të tjera të Shqipërisë, edhe në Korçë u ngrit e para fabrikë mielli me motor.<sup>3</sup>

Korça e dy dhjetëvjeçarëve të fundit të shekullit të kaluar ishte një qytet i zhvilluar për kohën dhe qendër e rëndësishme artizanati e tregtie. Për të Thimi Mitkoja shkruan: «Korça ka mbi 700 dyqane... Banorët dinë të ngjyrosin e të regjin lëkurën, të bëjnë qirinj, krehra leshi, samarë, sahatë, të punojnë argjendin, hekurin, bakrin etj. Ka dhe fotografë. Gratë merren me punimin e çorapeve, shiritave të leshtë, shajakut, pëlhurës, velenxave, qylymave».<sup>4</sup>

Si pasojë e këtij zhvillimi në Selanik, në Manastir, në Durrës, në Vlorë e gjetkë vendosen korçarë si agjentë të firmave tregtare korçare për lidhjet tregtare me botën e jashtme.

Por Korça e kësaj kohe dallohej sidomos për frymën lirishtetërore dhe arsimdashëse të banorëve të saj. Etja e madhe e popullit për arsimin në gjuhën am-

1) «Historia e Shqipërisë», vëll. II, 1973, f. 32.

2) Po aty, f. 35.

3) Po aty, f. 38.

4) «Fjamuri i Arbërit», 1884, nr. 10.

tare bëri që, më herët se kudo në Shqipëri, të çelen shkollat e para laike shqipe, si për djem ashtu dhe për vajza. Kësaj ngjarjeje të shënuar për tërë vendin, poeti ynë i shquar Naim Frashëri i kushtoi një poezi në të cilën, midis të tjerash, lexojmë:

*Lumja ti, moj Korç o lule  
q'i le pas shoqet e tua,  
Si trimi në ballë u sule,  
ta paçim për jetë hua!*

Periudhën e Rilindjes Kombëtare shoku Enver e ka cilësuar si: «një epokë revolucionare demokratike me shumë rëndësi në historinë dhe letërsinë e popullit tonë»,<sup>1</sup> si një epokë të ndritur të udhëhequr nga idetë iluministe, nga njerëzit tanë të shquar të asaj periudhe, si «epokën e daljes», nga errësira mesjetare feudale, imperialiste, në dritë, në kryengritje, në luftë për liri, pavarësi, demokraci, për dritë dhe arsim.

Në vargun e atdhetarëve tanë të shquar të periudhës së Rilindjes dhe të Pavarësisë bën pjesë dhe Marigo Posio, kjo grua që luftoi tërë jetën e saj për lirinë e atdheut dhe të femrës shqiptare.

Ajo rridhte nga një familje me tradita të shquara mëmëdhetarie. I ati, Kosta Poci, kishte lidhje farefisnie e sidomos idesh me shumë nga atdhetarët e shquar korçarë, që vepronin brenda dhe jashtë vendit. Veprën e tij atdhetare e ndeshim që më 1865 kur ai rreshtohet në listën e atyre që dhurojnë para për botimin e librave shqip, në përgjigje të kërkesës së atdhetarit Jani Vreto.

Kosta u martua me Lenkë Ballaurin nga Voskopoja, që kishte qenë një qendër e rëndësishme kulturore e arsimore. Ata e rregullonin jetën ekonomike me anën e një dyqani të vogël tregtie dhe u përpoqën që fëmijëve t'u jepnin shumë atdhedashuri dhe, me sa mundën, dhe dituri.

---

1) Enver Hoxha, Raporte e fjalime 1967-1968, f. 363.

Një burim na thotë se Marigoja mbaroi shkollën me 8 klasë në qytetin e saj të lindjes dhe që në vogëli ishte e zgjuar dhe i pëlqente literatura.<sup>1</sup> Kurse në një gazetë shkruhet: «Marigoja qysh së vogli u rrit me ndjenja kombëtare tue marrë pjesë në çdo lëvizje edhe me rrezik të jetës».<sup>2</sup>

Marigoja kishte dy vëllezër dhe dy motra. Për nevoja ekonomike vëllezërit emigruan në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të tri motrat ishin të mësuarra e patriotë, pohojnë bashkëkohësit që e kanë njohur nga afër këtë familje, por se ç'mësime morën dhe ku studiuan ende nuk mund të përgjigjemi dot me saktësi. Marigoja i futi edhe motrat në veprimtarinë atdhetare. Ajo dhe motra tjetër, Urania, figurojnë në listat e ndihmëtarëve të shtypit shqip të Rilindjes.<sup>3</sup>

Në vitet e fundit të jetës së tij Kosta s'arrinte dot ta ushqente familjen me të ardhurat e pakta të dyqanit. Për këtë arsye ai u detyrua të bëhet prift<sup>4</sup> pa hequr dorë asnjë çast nga idetë dhe veprimet e veta atdhetare.

Lidhjet e farefisnisë me Thimi Mitkon, Anastas Lakçen (Avramidhin), Spiro Ballkamenin, Spiridon e Tashko Ilon etj. forcuan gjithnjë e më shumë ndjenjat atdhetare të Marigosë dhe e lidhën atë pazgjidhshmërisht me fatet e çlirimit të Atdheut dhe të gruas shqiptare. Në këto rrethana ajo fillon t'i kushtohet tërësisht çështjes së atdheut. Edhe pse vajzë e re ajo nisi të spikasë jo vetëm midis bashkëmoshatareve, por edhe grave shqiptare më të moshuara të qytetit.

Deklamimi nga ana e saj i poezive të rilindësve tanë të shquar ngrinte peshë zemrat e grave dhe të gjithë atyre që e dëgjonin. E nisi këtë punë me farefisnin e saj dhe dalëngadalë e zgjeroi në lagje e qytet. Ajo

1) AqSh. Fondi 270, kutia 3, dosja 50, f. 44.

2) «Besa», Tiranë, 25 gusht 1932.

3) B. Sinani, Disa sqarime për jetën e Marigo Posios, «Studime historike», nr. 1. 1987, f. 225.

4) Mbështetur në profesionin e tij të ri, ai filloi të quhej Papakosta, ndaj në dekretin e dekorimit të së bijës ai figuron me këtë emër.



fliste kundër qëllimeve grabitqare të osmanllinjve, shovinistëve grekë dhe veglës së tyre Patrikanës së Stambollit.

Në këtë kohë ajo nisi t'u mësonte vajzave analfabete shkrim e këndim shqip.<sup>1</sup> Ndjenja e së bukurës e shoqëruar me shkathtësinë e rrallë të duarve e bënë atë qëndistaren e më vonë rrobaqepësen më të njohur të qytetit.

Vajza e re po rritej midis një opinioni të shëndoshë atdhetar, që zotëronte në atë kohë në Korçë. Për pikëpamjet e saj liridashëse qeveritarët turq dhe veglat e tyre filluan ta ndiqnin këmba-këmbës, prandaj Marigoja shpesh nuk qëndronte në familjen e saj, por strehohej nëpër farefis, sidomos te xhaxhai i saj Thoma Poçi. Atje ajo e ndiente veten disi më të sigurtë sepse në atë banesë kishte mbrojtjen e kushëririt të saj të parë, Arqilesë, i cili kishte dezertuar nga ushtria turke dhe për këtë arsye mbante fshehtëtas armë zjarri dhe kamë. Për t'i shpëtuar asqerëve dhe xhandarëve turq, në oborrin e shtëpisë kishin hapur një llagëm të nëndheshëm, sipër të cilit qenë vendosur pllaka të mëdha, njëra prej të cilave ishte e lëvizshme dhe shërbente si kapak për hendekun e nëndheshëm. Mbi të mbahej dhe kazani i madh i rrobave. Kur xhandarët vinin për kontroll Marigoja dhe i kushëriri fshiheshin atje, bashkë me armët që mund t'u duheshin për të çarë rrethimin.<sup>2</sup> Vajzat e familjes ku ajo strehohej ishin flokëkuqë, kështu kur vinte kushërira e tyre e re ato i mblidhnin bishtalecat dhe e mbanin kokën të mbuluar me shami për të mos rënë në sy vajza leshrazezë, Marigoja.

Mësuesit e saj ideorë ishin rilindësit tanë të mëdhenj, të cilët ajo i adhuronte dhe veprat e tyre i mësonte përmendësh. Një bashkëkohës i saj shkru-

---

1) Kujtime të bashkëkohësve.

2) Në vitin 1985 gjatë kohës që në atë ndërtesë u kryen disa punime rregulluese, u gjet njëra pushkë, kama dhe gjerdani i fishekëve, që sot janë të vendosura në Muzeun e Vlorës.

ante: «Ishte gojëmbël e buzëgaze, e zonja në fjalë, sa t'ia kthente mendjen edhe burrit më të peshuar, trimëreshë në vepra sa nuk i trembej syri as prej bajonetave turke. Ishte mjaft e gjallë dhe për kohën e saj kishte një kulturë të mirë, të shoqëruar nga një gjykim i fortë. Dinte shumë gjëra: njihte sidomos mirë përpjekjet e shqiptarëve për liri; kishte lexuar të gjithë poetët e Rilindjes sonë kombëtare, shumicën e vargjeve të të cilëve i dinte përmendësh.»<sup>1</sup> Me gjithë jetën e saj të pasur në ngjarje, siç dëshmojnë bashkëkohësit, dokumentacioni rreth saj është i varfër sepse për femrat në atë kohë shkruhej pak. Veç kësaj, trashëgimtarët që pat vdiqën shpejt, pa lënë nipër e mbesa, kështu që korrespondenca e saj dhe materiale të tjera nuk arritën të ruheshin prej ndokujt.

## 2. LUFTËTARE PËR LIRINË E SHQIPËRISË

Zonja Marigo, të cilën ne patriotët e quanim *Nënë* e *Kombit*, nuk ka kursyer gjë për Atdhenë.

Në vitet e para të shekullit tonë reaksioni osman në Korçë u ashpërsua shumë. Ai ndiqte e persekutonte të gjithë shqiptarët që merreshin me përhapjen e ideve atdhetare dhe të shkrimit e të shkollës shqipe. Për këtë arsye shumë atdhetarë korçarë u detyruan të lënë shtëpitë e tyre. Ata erdhën e u vendosën në Vlorë ku, që në çastet e para, gjetën përkrahjen dhe mbrojtjen e atdhetarëve vendës.

---

1) «Zonja Marigo dhe Flamuri Kombëtar», «Përpjekja shqiptare» Tiranë, viti II, nr. 13, janar 1938.

Në këto kushte, rreth vitit 1904,<sup>1</sup> Marigo Posio erdhi në Vlorë së bashku me bashkëshortin e saj. Ajo u strehua në Lagjen Muradie (sot lagjja «Hajro Çakërri») në një nga ato rrugica, që të nxirrte në sheshin kryesor të qytetit, shesh që hyri në historinë e vendit tonë si Sheshi i Flamurit. Shtypi i kohës, për veprimtarinë e madhe dhe kohën e gjatë që ajo jetoi familjarisht në Vlorë, filloi ta quante «zonja vlonjate». Ajo jetoi në rrugicën që mori dhe mban edhe sot emrin e dashamirësit të Shqipërisë dhe të luftëtarit për mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar, francezit Justin Godard.<sup>2</sup>

Marigoja ishte «një grua e re, e bukur, me shtat mesatar, e zgjuar dhe kur fliste për Shqipërinë e për lirinë e popullit shqiptar, fytyra e saj merrte një pamje energjike dhe mbushej me optimizëm. Dinte t'i bënte të gjithë për vete dhe për çdo punë që i shërbente çlirimit kombëtar e kish syrin të patrembur», — pohon veterani Ibrahim Shyti.<sup>3</sup>

Vlonjatë të moshuar tregojnë se Marigoja ishte një grua e shkathët që i bënte dora çdo gjë. Dinte të qepte dhe të qëndiste bukur. Që në vajzërinë e saj ajo kishte qëndisur një flamur fort të bukur dhe e ruante me kujdes të veçantë. U martua me Jovan Posion nga Hoçishti dhe, kur erdhi në Vlorë, bashkë me pajën e saj, kishte sjellë me vete edhe flamurin të cilin, të dy bashkëshortët, e ruanin si sytë e ballit. Në këtë shpër-

---

1) Dhori Strati, në familjen e të cilit Marigoja u bë kumbarë, pohon se ajo duhet të ketë ardhur në Vlorë para vitit 1900, se sipas thënies së të atit, Marigoja kishte shoqëri dhe respekt të veçantë për poetin patriot Dush Strati që vdiq më 1901 në moshën rreth 22 vjeç.

2) Justin Godard (1871-1956), personalitet politik francez me ide përparimtare, mik dhe dashamirës i Shqipërisë të cilën e mbrojti në fushën ndërkombëtare nga synimet e shovinistëve fqinjë dhe të fuqive imperialiste. Shkroi dy libra për vendin tonë: «Shqipëria më 1921» dhe «Shqipëria më 1922». Ai e vizitoi vendin tonë disa herë, përfshirë dhe vitin 1950, kur ishte kryetar nderi i shoqërisë së miqësisë Francë-Shqipëri.

3) «Lufta për çlirim kombëtar në vitet 1878-1912» (kuajtme veteranësh), mbledhur nga P. Pepo, Tiranë, 1962, f. 326.

ngulje, flamuri i qëndisur prej saj qëndronte gjithnjë i fshehur në mes të pajës si pasuria më e shtrenjtë e tyre.<sup>1</sup>

Mbesa e saj kujton se këtë flamur Mari-goja e vendosi në fund të syndyqit të pajës, të gjitha muret (anët) e tij i bëri me brumë e mbi të ngjiti gazeta turke që dhe sikur të kontrollohej, gazetat nuk do t'i grisnin, duke i pandehur si shtresa.<sup>2</sup>

Nevoja për të jetuar dhe shkathtësia e rrallë e duarve e bënte atë të mirënjohur midis grave dhe sidomos vajzave e nuseve të reja vlonjate. Ato vinin dendur në shtëpinë e saj dhe ndiqnin plot admirim jo vetëm bisedat atdhetare, por edhe aftësinë e saj për të prerë, qepur e qëndisur. Mjeshtëria e rrobaqepëses dhe qëndistares krijuan kushte të përshtatshme për afrimin e vajzave dhe të grave me të dhe një pretekst për hyrjen e daljen në shtëpinë e saj. Ky qe një rast i mirë që gratë e Vlorës të shikonin të qëndisur simbolin e kombit tonë, flamurin kombëtar, që aq bukur e kishte qëndisur ajo me majën e gjilpërës në bezen e kuqe.

Eftimia Posio në kujtimet e saj shkruan se Marigoja i porosiste vajzat vlonjate që «e para gjë që duhej të merrnin në pajë të ishte flamuri kombëtar».

Me të ardhur në Vlorë, Marigoja filloi një veprimtari të gjerë politiko-patriotike dhe emancipuese duke e shndërruar shtëpinë e saj në një çerdhe të vërtetë atdhetare, ku zhvilloheshin biseda e qaheshin halle për fatin e mëmëdheut e sidomos për gjendjen e keqe të gruas shqiptare. Ajo e kuptonte se si çlirimi i vendit ashtu dhe ai i gruas lidheshin drejtpërsëdrejti me zhvillimin kulturor. Për këtë, në radhë të parë, duhej që vajzat të mësonin shkrim e këndim. Ajo u mësoi shumë vajzave dhe nuseve të reja vlonjate alfabetin dhe u dha të lexonin gazeta e libra shqip. Në motivacionin e dekorimit pohohet pikërisht fakti se «ka punuar pa

1) Kujtime dhënë autorit.

2) Po aty.

u lodhur për mësimin e gjuhës shqipe». <sup>1</sup> Megjithëse nuk ka shërbyer ndonjëherë si mësuese ajo e kryente këtë detyrë në shtëpinë e saj. Për të thuhet se «shkruante mirë shqip dhe se shtëpia e saj ka qenë një vatër për patriotët, një klub tjetër krahas klubit «Labëria»». <sup>2</sup>

Atdhetari Ibrahim Shyti pohon se Marigoja ishte mishërimi i gruas së frymëzuar nga idealet e Rilindjes, energjike dhe e palodhur. Sa herë që takoheshin ajo i fliste atij për veprat e shkrimtarëve patriotë të Rilindjes. Prej gojës së saj ai mësoi dhe mbante mend deri në fund të jetës së tij vargje të tilla alegorike:

*Do vijnë prapë do vijnë,  
Do vijnë vera, behari,  
Bima, lulja do mbijnë,  
Të marrë shpirt shqipëtari.*

*Retë e zeza do përndahen,  
Do të shkojnë kohë e ftohtë,  
Lotët me vite do të thahen,  
Se do vijnë djell «i ngrohtë»». <sup>3</sup>*

Marigoja merrte pjesë gjallërisht në veprimtarinë atdhetare krah për krah me burrat. Mbi të gjitha ajo i propagandonte idetë patriotike midis grave të cilat ishin të etura për dituri meqenëse rrinin të mbyllura brenda mureve të shtëpisë. Ishte koha kur vazhdonte të vepronte me forcë zakoni anadollak, që me aq mjeshteri kishte mbjellë pushtuesi për të mbajtur gratë larg veprimtarive shoqërore.

Për veprimtarinë e dendur atdhetare që ajo zhvillonte në Vlorë në dhjetëvjeçarin e parë të shekullit tonë një bashkëkohës shkruan: «Zonja Marigo në

---

1) Dekret i Presidiumit të Kuvendit Popullor, nr. 3073, dt. 7 mars 1960.

2) «Lufta për çlirimin kombëtar», vepër e cit.

3) «Lufta për çlirim kombëtar», vepër e cit., f. 326.

shtëpi qëndiste, shkruante artikuj për gazetat, shkëmbente letra me miqtë atdhetarë të shpërndarë në të gjithë botën, u fliste grave të Vlorës për një Shqipëri të lirë, diskuton me burrat ngjarjet e ditës, për propagandën që duhej filluar, për luftën që duhej nisur».<sup>1</sup>

Ajo renditet nga bashkëkohësit jo thjesht si një burrëreshë, por «udhëheqëse shpirtnore e gjithë burrave të vërtetë shqiptarë, që luftuan me armë në dorë për lirinë e vendit tonë... të cilët në kohë dëshpërimi mbledheshin rreth Marigosë për të marrë shpirt (frymëzim — Z.B.) të ri nga shpirti i saj i zjarrtë që vlonte për liri dhe në kohë gëzimi mbështilleshin rreth saj që të merrnin nga goja e saj e ëmbël çmimin e lavdisë së tyre».<sup>2</sup>

Dokumente të tjera flasin se shumë veteranë të çështjes sonë kombëtare, si: Murat Toptani, Dervish Hima, Çerçiz Topulli, Mustafa Qulli, Pandeli Cale, Haki Glina, Ceno Sharra, Elmas Kanina, Hil Mosi, Mihal Grameno, Musa Çakërri, Hamit Lumi, Jani Minga, Ibrahim Shyti e të tjerë e kishin këtë vater si shtëpinë e tyre. Bashkëkohësit që e kanë njohur nga afër shkruanin në shtypin e kohës se Marigoja «mori pjesë në Komitetin e parë që u formua në Vlorë për shpëtimin e atdheut dhe e ndihmoi atë me të holla».

Një rol të rëndësishëm në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare të popullit të Vlorës ka luajtur klubi politik-patriotik dhe kulturor i Vlorës që mori emrin «La-

---

1) «Përpyekja shqipëtare», vep. e cit. Këtu në disa shkrime të bashkëkohësve pohohet se ajo ka shkruar shumë artikuj në shtypin para Shpalljes së Pavarësisë. Sot për sot në kemi mundur të identifikojmë vetëm pseudonimin «Shqiponja» me të cilin Marigoja ka bashkëpunuar në gazetën «Korça» duke i dërguar korrespondencat nga Vlora. Kjo bindje na krijohet nga fakti se shkrues i saj ishte Thanas Floqi, mik familjar, i strehuar prej saj gjatë kohës që ai vepronte në Vlorë. Për flamurët e shumtë që qëndiste, bashkëkohësit e quanin atë shqiponjë. Veç kësaj, nga problemet që ngre në artikujt dhe nga veçoritë e stilit dhe të gjuhës që përdor, kuptohet se ato i përkasin Marigosë.

2) A.Q.S.H. Fondi 270, kutia 3, dosja 50, f. 44.

bëria». Ky klub u hap më 1908 kur xhonturqit u detyruan t'u jepnin disa të drejta kombeve e popujve të shtypur të perandorisë së tyre, për t'i bërë për vete në luftë kundër sulltanit.

Krahas atdhetarëve të shquar një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e këtij klubi luajti edhe Mari-goja, e cila punonte sidomos me gratë. Ajo ishte një veprimtare e palodhur e klubit, propagandante punën e tij, jo vetëm me fjalë, në biseda e mbledhje të ndryshme me gratë, por dhe me anën e shkrimit të artikujve në shtypin kombëtar, që botohej jashtë Atdheut.

Populli i Vlorës e mbronte atdhetaren nga rreziqet që i kanoseshin dhe e nderonte. Rrethet e mëmëdhetarëve e vlerësonin siç e meritonte. Ajo ishte e mirëpritur plot respekt dhe dashamirësi nga populli, madje për të u thurën edhe vargje. Një vjershë 48-vargëshe e shkruar nga një emigrant shqiptar në Amerikë, e titulluar «Të lumtë»,<sup>1</sup> botuar në janar 1910, i kushtohet asaj. Do të mjaftonte vetëm kjo për të kuptuar se emri i saj ishte bërë i njohur në tërë botën shqiptare. Në vargjet e para ajo krahasohet me një «thëllëzë të zeshur», me një bilbil «kur zë ligjëron e s'pushon ditë e natë». Është kuptimplotë vargu «Me atë zë porsi shpatë», që mbyll 8 vargjet e para. Ajo cilësohet «si burim që buron kurdoherë» dhe që «S'është as shteron», e që në rrugën e saj «nuk prapset kurrë». Vjersha vazhdon:

*Si një lule që çel dimër verë,  
Po përhap kombësi në çdo vend,  
Është zjarr edhe flakë çdo kuvend,  
Ku ti lëçit porsi burrë.<sup>2</sup>*

Duke pohuar se Atdheu ka mjaft bij që nuk u shmangen therorive dhe nuk kursejnë as gjakun, autori e vlerëson si një grua që është krijuar për të

1) «Korça», 30 janar 1910.

2) Po aty.

stërvitur bashkatdhetarët që «me guxim të dalin në ballë». Më tej vjersha vazhdon:

*Mbaje flamurin të zjarrtë përpjetë,  
Mos pusho kudo je e qëndron,  
Se dëshira që ke të nderon,  
Të lartëson në çdo zemër,  
Mos u lodh, por vrapo me të shpejtë,  
Mos u kthe nga qielli qëllim...*

Autori me të drejtë e vlerëson lart duke e krahasuar me Dora d'Istrian dhe parashikon vendin e nderit që ajo do të zërë midis grave shqiptare.

*Dora d'Istria ish-shqiptare,  
Që shkëlqen si yll në histori,  
Ashtu shprenj Marigo edhe ti,  
Të shkëlqesh ndonjë ditë.*

*Mos u tremb, po u mbaj kordhëtare,  
Ndilli shoqet e tua në zgjim,  
Mëmëdhesë t'i sjellin fitim,  
E ti bijen një dritë.*

Lidhur me veprimtarinë që kryente Marigo Posio në këto vite të robërisë një atdhetar me pseudonimin «Një veteran korçar» shkruante: «Unë si një korçar e njoh fort mirë këtë zonjë, se në shtëpi të saj në Vlorë kemi ngrënë e kemi pirë dhe kemi bashkëpunuar në atë kohë të frikshme të tiranisë.»<sup>1</sup>

Veterani korçar pohon: «Unë dhe shokët e mi e kishim shtëpinë e saj bazën e veprimeve tona dhe jo njëherë e dy kishim hapur sekretet tona të Komitetit që kishim në atë kohë dhe kjo zonjë ishte katehisur me të gjithë qëllimet që kishim për rilindjen e Atdheut.

---

1) «Gazeta e re», 6 janar 1929.



Shumë herë kishim ardhur edhe në nevojë dhe jo vetëm që na ndihmonte pa i thënë ne, por edhe për Komitetin e zgjidhte qesen shpeshherë dhe as mbante hesap sa jepte».<sup>1</sup>

«Zonja Marigo, të cilën ne, patriotët, e quanim *Nënë e kombit* nuk ka kursyer gjë për Atdhenë. Unë, p.sh., jo vetëm që ja kam njohur shpirtin e madh dhe atë ndjenjë të rrallë që kishte ajo për Shqipërinë por dhe disa herë kam marrë dhe ndihma për Komitetin... Shtëpia e saj ishte e hapur për çdo patriot. Ne vetë dhe shokët tanë i thoshim ngahera që këto të mira në mos i difshim ne, le t'i dijë kombi dhe thoshim se një ditë kur të çlirohej Shqipëria, asaj do t'i jepej shpërblymi më i madh moral e material për punët e paçmuara dhe shërbimet që i bënte atdheut.»<sup>2</sup> — vazhdon të shkruajë veterani në kohën kur ajo ishte ende gjallë.

Dhe më poshtë veterani shpjegon se ajo nuk u burgos dhe nuk u internua ngaqë një gjë e tillë do të çonte në një revoltë të madhe popullore, se shqiptarët nuk do të pranonin që në qelitë turke të mbahej një motër e tyre. «Sa herë e rrezikoj jetën kjo zonjë, sa herë deshën ta bastisnin, e shpëtoi me anë të miqve, dhe sa herë deshën ta burgosnin e ta internonin, veçse autoritetet turke atëherë nuk deshën t'i jepnin rëndësi një gruaje që të mos merrnin përsipër shqiptarët (nënvizimi im-Z.B.). Nuk do të harroj kurrë sa na inkurajonte ne burrat, ndonëse kjo ishte një grua, aq sa na vinte turp të mos punonim me nxehtësi. Kam ende disa dëshmitarë të këtyre inkurajimeve, kur ne, disa herë u shtrënguam të iknim të veshur si gra myslimane natën që të shpëtonim nga rreziku». Në këtë punë ata janë ndihmuar nga Marigoja dhe veterani përmend si dëshmitarë të një veprimi të tillë atdhetarët e shquar Hamza Isain, Ibrahim Abdullahun, Mihal Gramenon, Muço Qullin, Çerçiz Topullin etj., prej të cilëve

---

1) Gazeta e re, 6 janar 1929.

2) «Gazeta e re, 6 janar 1929.

tre të parët ishin gjallë në kohën e botimit të këtyre kujtimeve.

Në një korrespondencë që shkruhej nga Vlora disa vjet para vdekjes së Marigo Posios përligjeshin mendimet dhe veprimet kombëtare të saj dhe pohohej se shtëpia e Marigo Posios në atë kohë quhej foleja e pelegrinazhit të atdhetarëve, se ajo nuk kurseu asgjë për Shqipërinë, se nuk u tremb nga burgu, nga litari dhe se ndihmoi gratë vlonjate të kuptonin më mirë se ç'është Atdheu duke e çuar kështu më tej ndërgjegjen e tyre kombëtare.<sup>1</sup>

Në lidhje me figurën dhe veprën e Marigosë atdhetari vlonjat bashkëkohës, Ibrahim Shtyti, në kujtimet e lëna shkruan: «Vajta takova zonjën Marigo Posio, patrioten e shkëlqyer të asaj kohe, e cila treti gjithë ç'kish për atdhe. Marigoja ishte një grua që i kishte lezet fjala kur fliste, se ishte trime dhe punëtore...»<sup>2</sup>. Për të kryer vepra në dobi të mëmëdheut Marigoja nuk veproi vetëm në shtëpinë e saj, në qytetin e Vlorës. Ajo u detyrua të merrte rrugën vetë nëpër qytete të ndryshme të Shqipërisë, madje dhe jashtë vendit, për të ndihmuar atdhetarët, që vepronin jashtë mëmëdheut, të cilëve u qe ndaluar të ktheheshin në tokën nënë. Në vitin 1910 u krijua komiteti «Bashkimi» për të organizuar kryengritjen kundër pushtesve osmanë. Ky komitet vepronte në krahinën e Labërisë dhe të Mallakastrës. Një degë e tij e kishte qendrën në Korfuz. Prandaj andej me anë varkarësh atdhetarë si Hamit Lumi e të tjerë dërgonin në Shqipëri jo vetëm materiale propagandistike, por dhe armë për kryengritësit.

Marigo Posio ishte një nga anëtarët e Komitetit të Fshehtë të Vlorës, rast tepër i rrallë që një grua të bënte pjesë në komitete burrash, ku hartoheshin planet për lirinë e Shqipërisë. Ky komitet e dërgoi Marigonë në Korfuz për të bashkërenduar veprimet me atdhetarët shqiptarë të atjeshëm. Nga Korfuzi ajo mbante ko-

1) «Gazeta e re», 20 dhjetor 1928

2) Kujtimet e Ibrahim Shtytit, në bashkëpunim me familje.



rrespondencë të rregullt me atdhetarët vlonjatë, midis të cilëve Ibrahim Shytin. Ajo i falenderonte ata «për lajmet që më çove» dhe i ngarkonte të kryenin veprime patriotike.

Në njërën nga letrat që i dërgon Ibrahim Shytit e porositi: «Të lutem fort po të jetë nevoja që të vesh gjer në Cakran të vesh një orë e më parë. Shpreh te atdhësia e juaj». <sup>1</sup> Guximi dhe trimëria ishin cilësi që i shtoheshin atdhetarizmit të saj. Në verën e vitit 1911, me pretekst se do të mjekohej, Marigoja shkoi në Korfuz, sikurse kishte vajtur edhe në qytete të tjera, Atje ajo u takua me të dërguarit e disa kolonive shqiptare, të cilët ishin mbledhur në ishullin grek për të hyrë së bashku me pushkë në dorë në Shqipëri, që të çonin më tej luftën për çlirimin kombëtar. Midis tyre ishin dhe përfaqësuesit e emigrantëve shqiptarë të Amerikës, të dërguar nga shoqëria «Besa-Besë». Ata «i dorëzuan zonjës Marigo një flamur të qëndisur me ar e në mëndafsh që, me gjithë shtizën dhe me një zhgabë të çeliktë, kishte kushtuar 140 dollarë. Ndërsa 13 vetat që përbënin çetën e Amerikës vuanin nëpër bodrumet e Gjirokastrës, zonja Marigo u kthye në Vlorë me flamurin e veshur në trup, nën teshat e përditshme, nga frika se mos ia gjenin rojtaret e doganës, sepse teshat e saj kontrolloheshin më imët nga çdo gjë tjetër». <sup>2</sup> Vetëkuptohet se arsyeja e këtij kontrolli të imët ishte ngaqë ajo merrrej me propagandë kombëtare dhe transportonte sidomos libra e gazeta shqipe të ndaluara.

### 3. MARIGOJA DHE ÇËSHTJA E FLAMURIT KOMBËTAR

*Cila dorë e pat punue,  
Kombit kush ia pat kushtue,  
At'flamur që valoi në Vlorë,  
Për me shpallë lirinë tonë?*

1) «Studime historike», 1976, nr. 1, f. 121-122.

2) «Përpyekja shqiptare», vep. e cit.

Njihet mirë pasioni i Marigosë për të qëndisur flamurë me zhgabën dykrenare në mes, po cili flamur u ngrit në Vlorë ditën e Shpalljes së Pavarësisë nga dora e Ismail Qemalit?

Ky fakt u bë objekt diskutimi për një kohë të gjatë.

Bejlerët e Vlorës thoshin se këtë flamur ua kishte falur atyre Don Aladro Kastrioti, i cili, siç dihet, ishte një aventurier politik, që pretendonte trashëgiminë e frontit shqiptar gjoja si pasardhës i derës së Kastriotëve.

Kleri katolik, nga ana e tij, nuk mund të mos përkrahte simpatizanët e tij, ndaj revista reaksionare «Hylli i dritës» e vitit 1937, nr. 11, shkruante se Ismail Qemali duke ardhur prej Vjene u ndal në Kotorr dhe atje «Lec Shkjezi, që kishte flamuj gjithfar masat, i dha një flamur të thjeshtë, kund dy metra të gjatë, mbasi i pat thënë Plaku: nuk e dua as tepër të madh, as tepër të vogël».

Këto thënie të rreme e pa baza nuk u pohuan prej asnjërit nga pjesëmarrësit e Kuvendit të Parë Kombëtar.

Varianti se ky flamur mund të jetë i përgatitur nga gratë atdhetare shqiptare të Amerikës gjithashtu është i pathemeltë, sepse ai ishte mjaft i madh dhe i qëndisur me fije ari, ndërsa flamuri që u ngrit ditën e Shpalljes së Pavarësisë ishte një flamur i qëndisur bukur, por thjesht. Përveç kësaj edhe gruaja që e shoqëroi Marigo Posion deri në fund të jetës së saj, Thina Ferra, pohon se flamuri i përgatitur nga gratë shqiptare të Amerikës, që ajo solli prej Korfuzit, u është dorëzuar dy korçarëve kur ata po niseshin për në Korçë».<sup>2</sup>

Në lidhje me këtë Ibrahim Shyti në kujtimet e veta shkruan: «Një grup patriotësh që erdhi nga Amerika zbritën në Korfuz më 1912 (duhet më 1911—Z.B.), kishin prurë një flamur me vete për në Shqipëri po si ta nxirrnin nga dogana? Marigoja u tha: «E nxjerr unë». e mori flamurin e ngjeshi për trupi, brenda rrobave,

---

1) «Përpjekja shqipëtare», vep. e cit.

dhe ia dorëzoi atij grupi patriotësh që zbritën në Vlorë. Është bërë njëfarë polemike në shtyp për këtë flamur, se disa thoshin që s'është ky flamur që u ngrit në Vlorë më 28 Nëntor, po është ngritur ai i Marigosë.»<sup>1</sup>

Një argument që flet në favor të Marigo Posios është dhe shkrimi i botuar në gazetën «Arbëria» që dilte në Gjirokastër në të cilin pohohet se flamurin kombëtar që u ngrit për të parën herë e pati «hartuar» me duart e veta zonja Marigo mbi copën e blerë te tregtari Diamanti sipas modelit të shqipes që kishin vizatuar patriotët Don Mark Vasa dhe Petro Fotografi. Autori i shkrimit pohon se për këtë kishin dijeni dhe veteranët atdhetarë Thanas Floqi, Hamza Isai, Imer Radhima e të tjerë, të cilët ishin bashkëpunëtorë për çështjen kombëtare me Marigo Posion. Shkrimi u botua kur të lartpërmendurit ishin gjallë. Bashkëpunëtorja e Marigosë, Thina Ferra, kujtonte: «Po atë ditë pikturuam edhe shumë flamuj të tjerë për t'ia shpërndarë popullit. Kishim edhe një shqipe të vogël që e lyenim me bojë të zeze dhe ku vulosnim qylafët e bardhë të gjithë lebërve që morën pjesë në manifestim.»<sup>2</sup>

Na e forcon këtë bindje dhe një shkrim tjetër që dilte në shtypin e kohës në të cilin thuhet se kur u njoftua mëvetësia e Shqipërisë prej Ismail Qemalit, Marigoja e «qëndisi me shpenzimet dhe duart e veta flamurin që valoi në Vlorë për shpalljen e lirisë mbas 5 shekujsh tiranie» dhe se punoi po me të hollat e veta më se 500 flamuj kombëtarë për zyrat e ndryshme.

Në një poezi të botuar në vitin 1934 në shtypin e kohës me titull «Marigo Posio», midis të tjerash, vargëzohet:

*Cila dorë e pat punue,  
Kombit kush ia pat kushtue,  
At' flamur që valoi në Vlorë.*

- 
- 1) Kujtimet e Ibrahim Shytit. Ruhen nga familja.
  - 2) «Përpyekja shqipëtare», vep. e cit.

Për me shpallë lirinë tonë?  
Ajo qe një atdhetare,  
Marigo, grua korçare,  
Që punoi porsì një burrë,  
Që s'iu shmang detyrës kurrë.  
Që shkriu plang e pasuri,  
Që shkriu jetën për Shqipëri,  
Për të cilën punoi tepër,  
Si me shkrime, me çdo vepër.  
Me komita pjesë mori,  
Faqebardhë Atdheun e nxori,  
Kjo grua s'do të harrohet  
Por gjithmonë do të kujtohet.

Atdhetari Thanas Floqi në «Jetëshkrimi im», duke bërë fjalë për ngjarjet e vitit 1908, shkruan: «U ndala në qytetin e Vlorës, ku të njohur e miq më pritën krahëhapur. Aty u njoha dhe u miqësova me shumë patriotë të këtij qyteti historik si me Marigo Posion... një patriote të flaktë e të çmuar».<sup>1</sup>

Ndërsa për ditët e Shpalljes së Pavarësisë, në të cilin ai ishte përfaqësues i Korçës në Kuvendin Kombëtar lexojmë: «Po gjatë atyre ditëve historike bashkë me kunatën e vëllait tim, Marigo Posion, si dhe me Petro Fotografën kemi përgatitur dhe gdhendur në dru bocën e flamurit që u përdor mandej për riprodhimin e qindra e mijra flamurëve të tjerë që u valvitën gjatë festës nëpër qytetin heroik të Vlorës».<sup>2</sup>

Të dhënat e botuara që para Çlirimit tregojnë se qëndisjen e flamurit kombëtar Marigoja e ka përdorur si një mjet për të ngjallur ndjenjat atdhetare, sidomos në radhën e grave. Flamujt e qendisur prej saj mba-heshin si një gjë e shenjtë e ruheshin si relika të rralla nga gratë e vajzat vlonjate.

---

1) Kujtimet e Thanas Floqit, të shkruara më 1941, ruhen nga familja në Elbasan.

2) «Përpyekja shqipëtare», vep, e cit.

Në pllakën përkujtimore prej mermeri që është vendosur në ndërtesën ku banonte Marigo Posio thuhet: «Në këtë shtëpi atdhetarja Marigo Posio qëndisi flamurin kombëtar, të cilin Heroi i Popullit Ismail Qemali e ngriti në Vlorë më 28 Nëntor 1912».

Këtë mendim na e forcon edhe Bastri Mullaj, mik i familjes Posio. Ai pohon: «Besoj se nuk do të ketë pasur tjetër grua në Shqipëri që të ketë qëndisur aq flamuj kombëtarë, shumicën e të cilëve e shpërndante pa pagesë në raste festash, ceremonish, demonstratash. Njëpër shumë familje vlonjate dhe para Shpalljes së Pavarësisë mbaheshin të fshehur njëpër sepetet e grave flamujt e qëndisur nga Marigoja, e cila për këtë punë mbledhte rreth saj edhe mjaft vajza dhe i mësonte të qëndisnin, por të parën gjë që qëndisnin ishte shqiponja me dy kokë në bezen e kuqe.»<sup>1</sup>

Në gazetën «Zëri i Vlorës»<sup>2</sup> dhe «Përpara»<sup>3</sup> si dhe në revistën «Shqiptarja e re»<sup>4</sup> shprehet mendimi, se Marigo Posio është autorja e flamurit historik që u ngrit më 28 Nëntor të vitit 1912 në Vlorë.

Vlonjatët e tjerë të moshuar përmendin këto fakte në lidhje me Marigo Posion: «Flamuj të tjerë që u ngritën në dritaret dhe te porta e shtëpisë së Kongresit nuk ishin të qëndisur, ata ishin flamuj të thjeshtë; një rrobë e kuqe e stampuar, me shqiponjën e zezë në mes. Këta si dhe shumë flamuj të tjerë, që u ngritën në sallë dhe nëpër qytet, i qepi dhe i stamposi zonja Marigo, së bashku me aktivistet e saj. Ato bënë edhe flamuj të tjerë me shqiponja të prera në rrobë të zezë dhe të qepura në fushë të kuqe. Stampa e flamurit bëhej në hajatin e shtëpisë së zonjës Marigo, i cili atë ditë ishte kthyer në një punishte të vërtetë flamurësh.»<sup>5</sup>

Referencat:

- 1) Kujtimet e Bastri Mullait dhënë autorit.
- 2) «Zëri i Vlorës», nr. 82. Vlorë 2 tetor 1972.
- 3) «Përpara». Korçë 18 tetor 1972.
- 4) Ll. Durolli «Marigo Posio dhe flamuri kombëtar», «Shqiptarja e re», Tiranë 1972, nr. 12.
- 5) Po aty.

Këtë mendim e pohon edhe artikulli i botuar në gazetën «Zëri i Vlorës», në të cilin, midis të tjerash, lexojmë: «Hajati i shtëpisë së Marigo Posios 2-3 ditë më parë se të shpallej Pavarësia u kthye në një punishte të vogël flamujsh ku Marigoja me vajzat e saj dhe me aktivistë të tjerë të klubit «Labëria», Thanas Floqin e Petro Dhimitër Fotografën, qepën e stamposën me qindra flamuj të tjerë të thjeshtë me të cilët zbukuruan sallën e Kongresit e gjithë qytetin e Vlorës më 28 Nëntor të vitit 1912».<sup>1</sup>

#### 4. GJITHË FAMILJA POSIO NË SHËRBIM TË ATDHEUT DHE TË PËRPARIMIT

Për punët kombëtare Marigoja gëzonte edhe përkrahjen e të shoqit, Jovanit, i cili gjithashtu i ishte kushtuar kësaj çështjeje. Dhe nuk kishte si të ndodhte ndryshe. Ai e kishte filluar jetën duke luftuar për bukën e gojës. Që në moshën 9-vjeçare ai kishte hyrë si shërbëtor në një familje tregtare në Korçë, me origjinë nga Hoçishtit. Djali i ri plot virtyte, që nga dita në ditë po hidhte shtat të bukur, u hyri në sy të zotërve të shtëpisë dhe vajzës së tyre gjysmë të paralizuar. Ndodhi ajo që pritej: martesë midis dy të rinjve. Por, nuk kaloi shumë dhe gruaja e re vdiq, pa i lënë ndonjë fëmijë. Miqësia midis këtyre dy familjeve u ruajt dhe më pas. Ata e dërguan Jovanin në dyqanet që kishin hapur në Vlorë. Më vonë, me të ardhurat që siguroi, Jovani mundi të çelë një dyqan të vetin.

Çifti Posio vazhdoi ta rregullonte jetën me anën e këtij dyqani të vogël dhe me qepjet e qëndisjet e Marigosë. Ndërkaq, Jovani merrej dhe me veprimtari atdhetare. Bashkë me të shoqen, Marigonë, ata e shndë-

---

1) M. Jupi, «Marigo Posio përhapëse e ndjenjave patriotike të gratë shqiptare», «Zëri i Vlorës» 12 tetor 1972.



rruan shtëpinë e tyre në një fole të ngrohtë për atdhetarët e vërtetë. Jovani nuk mungoi të jepte ndihmesën e tij edhe për ngritjen e frymës së atdhedashurisë, përmes pjesëmarrjes në veprimtaritë e klubit të shquar patriotik «Labëria», që zhvillonte një veprimtari të gjerrë atdhetare gjatë viteve 1908-1912.

Emri i Jovanit figuron në listën e ndihmëtarëve të gazetës përparimtare «Korça»<sup>1</sup>, e cila drejtohej nga atdhetari Sami Pojani. Ndihmë financiare ai ka dhënë dhe për mbajtjen e shkollës shqipe të Korçës.<sup>2</sup>

Atdhetari vlonjat Ymer Picari kujton: «Familja Posio ishte një familje që dallohej në fushën e patriotizmit. Në dyqanin e tij të vogël Jovani mbante dhe shiste edhe libra. Para Shpalljes së Pavarësisë ai shpërndante fshehtazi gazeta dhe libra shqipe të ndaluara e sidomos tekste shkollore shqipe që hynin në Vlorë nga jashtë ilegalisht».<sup>3</sup> Librat i sillnin atdhetari Hamit Lumi nga Vermiku dhe anëtarë të tjerë. Mulla Xhaferri nga Drashovica, që kishte jetuar për shumë vjet në familjen e Ismail Qemalit, ishte mik dhe bashkëpunëtor me familjen Posio për përhapjen e shkrimt dhe të librave shqip.

Në muajin shkurt të vitit 1914, së bashku me atdhetarë të tjerë vlonjatë, Jovani u ngrit kundër hapjes së shkollave në gjuhën greke në Vlorë e gjetkë dhe nënshkruan një protestë kundër vendimit të Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, i cili i jepte leje klerit ortodoks fanariot për të hapur e mbajtur shkolla në gjuhë të huaj. Ai ishte përkrahës i arsimit kombëtar në gjuhën shqipe.<sup>4</sup>

Ndjenjën e atdhedashurisë Jovani e ruajti gjithë je-

---

1) Si ndihmëtar i kësaj gazete ishte dhe Kristo Poçi, i vëllai i Marigosë, emigrant ekonomik në SHBA.

2) «Lidhja ortodokse», Korçë, 1 shëndre (dhjetor) 1909.

3) Kujtime të Ymer Picarit.

4) «Përlindja e Shqipniës», Vlorë, datë 12/25 shkurt 1914.

tën dhe u përpoq ta nguliste dhe tek të tjerët, sidomos në fëmijët dhe farefisën e tij.<sup>1</sup>

Çifti Posio lindi 4 fëmijë, një djalë e tri vajza, për të cilët treguan një kujdes të veçantë duke i shkolluar dhe duke u kujdesur sidomos për edukimin e tyre atdhetar. Edhe fëmijët u dalluan midis bashkëmoshatarëve në mësimë dhe veprimtari atdhetare, duke pasur si model shembullin e prindërve. Vajza e madhe, Evridhiqi, studioi në Trieste, kurse djali, Vaso, vazhdoi studimet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në degën e muzikës, nën kujdesin e vëllait të Marigosë. Ferriqi studioi në fillim në SHBA dhe pastaj në një kolegji anglisht-italisht në Romë.<sup>2</sup>

Kronikat e kohës na njoftojnë se në kishën katolike të Vlorës, që drejtohej nga atdhetari dom Mark Vasa, predikimet bëheshin në gjuhën shqipe, gjë e rrallë, por mjaft e rëndësishme për kohën në të cilën feja detyronte që katolikët të predikonin në latinisht, ndërsa ortodoksët në greqisht. Atje dëgjohet dhe zëri melodioz i bijës së Marigosë, Evridhiqit, e cila këngën e saj në gjuhën amtare, ku kërkonte lirinë e atdheut, e shoqëronte me mandolinë. Ajo mernte pjesë dhe në orkestrinë që kishte krijuar klubi «Labëria». Kjo or-

---

1) Mbesa e Jovanit, Eftimia Posio, kujton se si vitet e fundit të jetës ai i kaloi në Hoçisht. Në muret e shtëpisë së tij qëndronin vazhdimisht flamuri kombëtar dhe shumë fotografi atdhetarësh. «Ditën e 28 Nëntorit tek ne bëhej festë e madhe», — shkruan ajo. Bëheshin vizita jo vetëm nga bashkëfshatarët, por vinin atdhetarë nga të gjitha fshatrat e Devollit duke ditur se e shoqja e tij kishte qëndisur flamurin historik. Dhe ai fliste pa pushim për këtë ditë që e quante ditën më të shtrenjtë. Kur afrohej festa ai i thoshte Eftimisë: «Nxirre atë të shenjtin në dritare!», dhe përlojej duke kujtuar festimin e ditës së flamurit në Vlorë. Jovani në Hoçisht vazhdoi të bashkëpunojë me atdhetarët e atjeshëm, sidomos me Kristaq Shqiptarin dhe Pandi Stojkon. Fliste shpesh për takimet me Isa Boletinin, Ismail Qemalin dhe të tjerë. Eftimia shkruan se këto biseda atdhetare e frymëzuan atë për të marrë pjesë më vonë me armë në dorë në rreshtat partizane.

2) B. Sinani, Disa sqarime e plotësime për jetën e Marigo Posios, «Studime historike», 1987, nr. 1, f. 226.

kestrinë u bë një nga përhapëset më të zjarrrta të këngëve atdhetare në Vlorë.

Nuk mbeti pa u shquar dhe biri i kësaj familjeje, Vasoja. Në moshë fare të re ai mori pjesë në një nga veprimtaritë kryesore kulturore që u zhvillua në Vlorë dhe mund të rreshtohet ndër artistët e parë vlonjatë që organizuan shfaqjen e parë teatrore në këtë qytet me dramën historike «Vdekja e Pirros» të Mihal Gramenos. Në këtë dramë, e cila sipas shtypit të kohës u luajt me mjeshhtëri dhe dituri të madhe, Vaso Posio luajti në rolin e Aleksandrit.

Dashuria për atdhe bënte që djaloshi Vaso Posio, dhe pse ishte nxënës jashtë shtetit, të kursente nga goja e të dhuronte para për shoqërinë atdhetare «Përparimi» të Korçës, e cila kishte si qëllim të ndihmonte arsimin kombëtar dhe të siguronte fonde për mbajtjen e Shkollës Normale të Elbasanit. Ai dallohej në mësim në një shkallë të atillë saqë shtypi shqiptar që botohej në Amerikë në një artikull njofton se «Vaso Posio, djalë 14 vjeç, shqiptar nga Vlora, i kapërceu të 58 shokët në çdo pikëpamje» dhe uron djaloshin dhe prindërit duke «dëshiruar la e më la».<sup>1</sup>

Ndihmesë të rëndësishme në emancipimin e vajzës dhe të gruas shqiptare dha sidomos bija tjetër e kësaj familjeje Fereniqi, e cila shkroi me mjaft sukses në gazetën «Mbrojtja Kombëtare» dhe sidomos si redaktore e «Shpresës kombëtare», që u botuan në Vlorë në fillim të dhjetëvjeçarit të tretë të shekullit tonë. Ajo shquhet jo vetëm për problemet që ngre, të cilat do të trajtohen kur të bëjmë fjalë për gazetën, por edhe për mjeshhtërinë e për stilin e ëmbël që përdorte. Bashkëkohësit e vlerësonin atë si një vajzë nga të paktat që ka parë Shqipëria, e vaditur me gjithë mësimet enciklopedike, e zonja e gjashtë gjuhëve evropiane, të cilat i fliste e i shkruante pa gabime, që ishte gati të flinte jetën e saj për lulëzimin e Shqipërisë dhe si

---

1) «Zëri i popullit», Nju-Jork, 18 shkurt 1913. Ky shkrim na bën të pohojmë se Vaso Posio ka lindur më 1899.

shkrimtare nuk kishte shoqe për mendimet e larta që shfaqte. Për të shkruhet se në artikujt e zjarrtë të saj shkëlqente ideali i naltë dhe filopatria e rrallë e një atdhetareje të vërtetë.

## 5. KRIJUESE E ORGANIZATËS SË PARË TË GRAVE VLONJATE DHE SHPËTIMTARE E JETËS SË SHUMË REFUGJATËVE

Shpallja e Pavarësisë, si për të gjithë popullin shqiptar edhe për Marigonë, ishte një ngjarje e shënuar, një çast që i dha fund sundimit të huaj anadollak dhe u preu krahët synimeve të shovinistëve fqinjë. Pas kësaj ajo vazhdon më me ngulm veprën e saj në dobi të mëmëdheut. Ja seç shkruan shtypi i kohës për të: «Pas Shpalljes së Pavarësisë, zonja Marigo nuk mënon së punuari për çështjen kombëtare. Është bashkëpunëtore e Ismail Qemalit, të cilit më 28 Nëntor 1912 i jep flamarin që do të shohë për të parën herë dritën e diellit të shkëlqyer shqiptar. Dera e oborrit të saj tani i hap të dyja kanatet për të pritur e përcjellë nacionalistë (atdhetarë — Z.B.). Oda e miqve bëhet qendra kryesore ku rrihen problemet, e koklavitura të ditës, është salloni, ku aktorët e Shqipërisë së porsalindur lexojnë me zë të lartë, ashtu si bënin poetët frëngj të shekullit të tetëmbëdhjetë.

Në këtë kohë ajo ktheu sytë nga një fushë tjetër e palëvruar të cilën e kishte kujdes për vite me radhë: nga rrethi i grave. Nis më parë këshillat, propagandën, ju flet zonjave të cilësdo klasë të bejlerëve, të tregtarëve, shërbëtorëve të tyre, grave të pasura dhe të varfëra. Më vonë propozon mbledhjen e një kongresi të gruas shqiptare dhe ia arrin qëllimit. Në krye të vitit 1914 themelohet shoqëria «Shpresa kombëtare» në të cilën ajo «si më e ditura grua zgjidhet sekretare».<sup>1</sup>

<sup>1</sup> «Përpjekja shqiptare», vep. e cit.

Pra, në kundërshtim me kushtet e kohës Marigoja lufton që shoqërisë së grave t'i japë një karakter sa më demokratik jo vetëm duke u bazuar në përmbajtjen e programit, por edhe në pjesëmarrëset e kësaj shoqërie, të cilat në një formë ose në një tjetër do të shprehnin interesat e tyre klasore.

Me Shpalljen e Pavarësisë u krijuan kushte të mira pune për propagandimin e ideve kombëtare, por Qeveria e Përkohshme e Vlorës nuk pati jetë të gjatë. E ndodhur para komplotesh të forcave reaksionare të brendshme dhe të jashtme ajo u detyrua që në mars të vitit 1914 t'ia lëshojë pushtetin pjellës së kombinimeve ndër imperialiste të Fuqive të Mëdha, princ Vidit. Edhe më parë veprimtaria e saj ishte penguar seriozisht nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit.

Viti 1914 ishte një nga vitet më të përzier në jetën tonë politike. Ky ishte dhe viti i shpërthimit të Luftës së Parë Botërore, e cila e shndërroi Shqipërinë në një arenë luftimesh midis fuqive ndërluftuese të blloqeve imperialiste, në të cilën nuk mbetën pa marrë pjesë dhe shovinistët fqinjë. Shqipërisë i ishin njohur kufijtë që në vitin 1913 nga Konferenca e Londrës, por shtetet kufitare, megjithëse grabitën mjaft toka të truallit shqiptar, nuk e pranonin as vijën kufitare të vitit 1913.

Ushtritë shoviniste greke kishin vërshuar dhe me zjarr e hekur digjnin e shkatërronin gjithçka që gjenin përpara. Ata pushtuan tokat e prefekturës së Korçës dhe asaj të Gjirokastrës dhe ishin në prag të Vlorës.

Ndërsa burrat me heroizmin e pashoq luftonin kundër pushtuesit, gratë, pleqtë dhe fëmijët e krahinës së Labërisë u detyruan të lënë shtëpitë e tyre dhe të nisen drejt Vlorës për të gjetur shpëtim. Ullishtet e Vlorës dhe të Kaninës u mbushën me të ardhur, që s'kishin as bukë as strehim.

Gazetari patriot Sali Nivica e vajton kështu vuajtjen e muhaxhirëve: «Kanë lënë plëngën e tyre shkret,

foshnjat e tyre nën maja të mprehta të bajonetave greke, kanë vrapuar me shpirt ndër dhëmbë e janë futur ndën gji të kësaj krahine, të shpëtuar gjer më sot nga rrebeshi i gjakut e i dekies, e si po i sheh e do të shohësh kanë zënë që këtu e gjer në kufij të autonomistëve rrëzët e ullaive, majat e kodrave, këndet e anëve të rrugëve, buzët e lumenjve...» Dhe me të drejtë ai këtë gjendje e shpjegon si pasojë e «tregtisë evropiane, që po vepron mbi trupin e lënguar të Atdheut tonë, i tradhtisë që punon parësia faqezezë e vendit tonë».<sup>1</sup>

E tronditur dhe e revoltuar nga kjo situatë, studiuesja dhe gazetarja angleze Edit Durhan, mikeshë e popullit tonë, shkruante: «Këtu s'kam vend për të shkruar tmerret që pas disa javë që ndjenja atje... grekët (shovinistët grekë — Z.B.) digjnin atje ku shkelnin... Refugjatët po zvarriteshin në Vlorë të këputur nga mendimet. Me mijëra shtriheshin në ullaivtë e Vlorës. S'kishte as ushqim, as barëra për ta. Vapa ishte e paduruar. Kur jetoj këtë kohë, më duket sikur jam në ndonjë ëndërr të tmerruar».<sup>2</sup>

E prekur thellë nga këto skena të tmerrshme si çdo zemër e vërtetë shqiptare filloi përpjekjet për të mbledhur ndihma për këta të mjeruar, të uritur, e të rraskapitur. Në lidhje me këtë veprimtari patriotike lexojmë: «Vepra më e mirë për kohën, kur një mori njerëzish të plagosur në luftë e të sëmurë, janë duke vdekur urie e së ftohti nëpër ullaivtë e Vlorës, ishte ndihma për muhaxhirët.

...Nis atëherë fushata e ndihmave më me nxehtësi. Zonja Marigo bashkë me dy a tri gra të tjera, shkon shtëpi më shtëpi, troket derë më derë... S'lë grua pa kapur. Te dyert e paçelura pret gjysëm ore e nga një orë më këmbë gjersa të çelen. Gjithkush kontribuon me diçka. Dikush jep dhjetshen për muhaxhirët, dikush kacidhen. Dhe me dhjetshë e me kacidhe mbli-dhet një shumë e madhe 21 813 grosh.

1) «Populli», 20 qershor 1914.

2) Edit Durhan, «20 vjet ngatërresa ballkanike».

Lista e ndihmëtarëve-edhe atyre që për mungesa groshi, kishin dhënë vetëm nga njëzet e nga tridhjet para botohet në fletoren «Populli»<sup>1</sup>.

Është lista e vuajtjeve të kësaj zonje nacionaliste, qindra emra do të thotë, qindra dyer të trokitura, qindra shtëpi të vizituara, punë që kërkon djersë...<sup>2</sup>

Një muhaxhire e atyre viteve, Hava Braho, që humbi nga vuajtjet, uria dhe sëmundjet vëllain e vetëm kujton: «Megjithëse isha e vogël, tmerret e dimrit dhe të pranverës së vitit 1914 nuk do t'i harroj kurrë. Jetonim keq e mos më keq në ullishtat e Vlorës. Nuk kishim jo vetëm strehë, shtresa e mbulesa, por as ushqim për të ngrënë. Sëmundja shkurtoi sidomos fëmijët. Se si e kemi mbajtur shpirtin gjallë as unë nuk e di... Po ja, një ditë erdhën disa gra në krye të të cilave qëndronte një grua mesatare, e veshur alla frënga, që e thërrisnin zonja Marigo. Ajo shkonte çadër më çadër, strehë më strehë, dhe u ndante njerëzve ushqime, batanije dhe veshje. Të gjitha nënat tona e uronin «Rrofsh e qofsh e përparofsh!». Kursë ajo thoshte: «Rroftë e përparoftë Shqipëria!». Kishte mbledhur shumë gjëra nga gratë e Vlorës dhe me to u mbajti njerëzve shpirtin gjallë».<sup>3</sup>

Marigo Posio bëri përpjekje që lëvizja për të ndihmuar muhaxhirët të mos mbetej e kufizuar vetëm në qytetin e Vlorës, por të përhapej në tërë Shqipërinë dhe madje edhe në kolonitë shqiptare jashtë Atdheut.

Për këtë u dërguan shumë letra të thjeshta dhe të porositura në të katër anët e botës.<sup>4</sup>

Me ndihmat e mbledhura nga populli u blenë dhe

---

1) «Populli», Vlorë 20 qershor 1914.

2) «Përpjekja shqipëtare», vep e cit.

3) Kujtime dhënë autorit.

4) «Populli», 20 qershor 1914. Në kujtimet e Aleksandra Ilos, mbledhur nga Zhaneta Poçi e dhënë autorit, thuhet se Marigoja i kërkoi Kolonisë Shqiptare të Bukureshtit, përmes kushërinjve të saj, atdhetarëve Spiridon e Tashko Iló, ndihma për muhaxhirët e Shqipërisë së Jugut, të cilët u detyruan të braktisin vatrat e tyre.

iu shpërndanë muhaxhirëve veshmbathje, shtresa-mbulesa sidomos për spitalin e të plagosurve në luftë kundër shovinistëve.<sup>1</sup>

Ndërkaq, Marigoja nuk lë pa kritikuar zonjat e pasura të cilat nuk deshën të zgjidhnin kuletën, megjithëse e hiqnin veten për zonja filantropike. Ato madje i përmend me emër dhe kërkon që «shqiptarët atdhetarë me bojkotazh t'u rrëfejnë e të shohin ku e me kë i fitojnë të hollat, në Shqipëri me shqiptarët apo në Greqi me grekërit, të cilëve me dëshirë të madhe u japin ndihmat e tyre».<sup>2</sup>

Shovinistët serbë e malazezë kryen krime të përbindshme ndaj shqiptarëve të zonave të pushtuara. Për krimet e tyre një oficer serb shkruante: «... mund të them se këtu po bëhen gjëra të tmerrshme. Jam tmerruar dhe pyes gjithnjë se si njerëzit mund të jenë kaq barbarë për të kryer të tilla mizori... Nuk ka veçse kufoma, pluhur e hi».<sup>3</sup> Ata pak që mundën të shpëtonin u vendosën nëpër qytete, midis të cilëve dhe në Shkodër.

Marigoja, që i dhimbte zemra për të gjithë shqiptarët e masakruar, shkon në Shkodër me detyrën e përgjegjëses së shoqërisë «Shpresa kombëtare», për të ndihmuar muhaxhirët e grumbulluar në këtë qytet.

Më 11 tetor të vitit 1914 ajo u dërgon nga Shkodra një letër dy veprintarëve të «Shpresës kombëtare», në të cilën shpreh shqetësimin për refugjatët e vuajtur në atë qytet, ku «siklete të mëdha heqin të mjerët shqipëtarë që kanë ardhur si muhaxhirë» dhe se «këta të ngratë po vdesin uri». Atdhetarja kërkon që shoqëria «Shpresa kombëtare» t'i ndihmojë se «e meritojnë këtë ndihmë, ca më shumë se ata që ishin çahireve të Vlorës, për të cilët populli u kujdes me sa mundi». Ajo kërkon që paratë t'i dërgojnë «një orë më parë dhe kjo ndihmë ka për të qenë e paharruar».<sup>4</sup>

1) «Populli», 6 gusht 1914.

2) Po aty.

3) «Historia e Shqipërisë», vëll. II, Tiranë, 1985, f. 365.

4) AQSH. Fondi 56, kutia 5, dosja 104 (mikrofilm).



## 6. VEPRIMTARE PËR ÇLIRIMIN E VLORËS DHE MBROJTJEN E AVNIUT

Më 25 dhjetor të vitit 1914 imperialistët italianë kurdisën një incident dhe zbarkuan në Vlorë me forca ushtarake-detare, të cilat, pas tri ditësh, u përforcuan me trupa tokësore.

Populli me në krye atdhetarët e pritën plot zemërim këtë pushtim dhe luftuan me të gjitha forcat për mbrojtjen e vendit.

Viti 1919 shënoi një fatkeqësi të madhe për familjen Posio. Djali i tyre i vetëm, Vasoja, duke u kthyer nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ku vazhonte shkollën e mesme për muzikë, vdiq gjatë rrugës. Plaga ishte tepër e rëndë. Për familjen Posio fatkeqësive të atdheut iu shtua dhe tragjedia familjare. Por atdheu është mbi të gjitha, prandaj dhe Marigoja me Jovanin nuk e humbën toruan. Ata vazhduan luftën e tyre me të gjitha forcat për të mirën e vendit.

Më 28 Nëntor 1918, me rastin e 7-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë, në Vlorë u organizuan demonstrata antiimperialiste në të cilat populli u përlesh me karabinierinë italiane.

Marigo Posio e përkrahu me ç'mundi luftën antiimperialiste që bëri populli ynë më 1920 kundër pushtuesve italianë, të cilët me mbarimin e Luftës së Parë Botërore, as që kishin ndër mend të largoheshin nga Shqipëria.

Më 13 qershor 1920, në kulmin e zhvillimit të betejës me imperialistët italianë, në Paris, atdhetari Avni Rustemi vrau kryetradhtarin Esat Pashën. Vlora më 3 shtator u çlirua, kurse djaloshi libohovit vuante në qelinë e burgut francez. Jeta e tij duhej shpëtuar me çdo kusht me anën e veprimeve të gjithanshme të përbashkëta në shkallë kombëtare. Në këtë gjë një kontribut të veçantë dhanë edhe gratë e Vlorës në krye të të cilave qëndronte Marigo Posio. Ato i kërkojnë jurisë së Gjykatës franceze dhe ministrit të Drejtësisë

së Francës «të marrë parasysh dëshirën tonë të flaktë për të parë të lirë Avni Rustemin, i cili duke dashur të çlirojë Atdheun e tij nga despotizmi, vrau Esat Top-tanin dhe shpëtoi Shqipërinë tonë nga rreziku që i kërcënohej».<sup>1</sup>

Telegrame me përmbajtje të tillë gratë e Vlorës u drejtuan dhe gazetave «Temps», «Matin», «Information», «Petit Parisien», «Figaro», «Eco de Pari», «Tajms», «Gazete de Luzane», «Zhurnal de Zhëneve», «Cicago», «Tribjun», «Dielli»<sup>2</sup> dhe ndërsa lista e ndih-mëtarëve për Avni Rustemin mbushej me emra bu-rrash, në rastin e familjes Posio figuron «Jovan dhe e shoqja».

Aktit të Avni Rustemit Marigoja i thuri një vjershë plot frymëzim në të cilën i këndohet atdhetarizmit dhe guximit të tij.

Midis të tjerash lexojmë:

*Ti vrapove porsì plumbi,  
Ti u bëre er e hije,  
Shkele, shkove dhe e shove,  
Shqipërinë e shpëtove.*<sup>3</sup>

Në këto katër vargje Marigoja, me krahasime të go-ditura artistikisht dhe të mbushura me metafora, na jep plot dinamizëm veprimet energjike të Avniut për ta gjetur veten para tradhtarit, e aty për aty del kurorë-zimi i suksesshëm i aksionit atdhetar që çoi në zhduk-jen e pashait kriminel.

Ata që krijojnë vepra të mëdha populli i emërton me «bëri një urë në det».

*Ti u bëre me të vërtetë  
një urë në këtë det.  
Qysh e bëra, qysh u bë?*

1) AQSH. Fondi Avni Rustemi, dosja nr. 9.

2) «Shpresa kombëtare», 6 shkurt 1921.

3) Po aty.

*Bota thotë se për këtë  
nuk mjafton fuqi e robit,  
të shkel te gjurma e korbit,  
nuk e bën dot një njeri,  
një të tillë mrekulli.*

Autorja e kupton vështirësinë e ndeshjes së djaloshit trim me tradhtarin e regjur dhe e vlerëson Avniun si hero të ri duke i caktuar dhe vendin e tij të veçantë në historinë tonë kombëtare:

*Nuk bën dot një njeri  
veçse ti, hero i ri,  
ti e bërë dhe u bërë  
shum' i madh në histori.*

Në këtë kohë Marigoja botoi edhe një poezi tjetër me motiv të theksuar atdhetar kushtuar dëshmorëve të Luftës së Vlorës duke u përqendruar sidomos te fati i familjeve të tyre. Në poezinë «Për dëshmorët»<sup>1</sup> Marigoja shtron një problem shumë të mpërthtë për kohën: ndihmën që duhet t'u jepej familjeve të luftëtarëve të rënë, të cilat vuanin dhe kërcënoheshin të vdisnin nga uria. Duke marrë pjesë në vuajtjet e familjeve, të rënë e të cilëve «Këmbyen kokën me Vlorën», autorja kërkon që të paktën t'u pakësohen shqetësimet ekonomike:

*Jepi dorën, jepi dorën  
këti djali, që i ati  
e dha tërë atë që pati:  
këmbeu kokën me Vlorën.*

*Jepi dorën, jepi dorën  
kësaj mëme, që i biri*

---

1) «Shpresa kombëtare», 3 prill 1921.

*ju nda nga vatra, nga gjiri  
e la kërcu të gjorën.*

*Jepi dorën dhe asaj  
asaj vajze që rënkon  
atin e saj e kërkon...*

*Vlora qysh do ta harroj  
atë që tha dhe u tha  
maj malit Barçalla?<sup>1</sup>*

Nuk mund të mos vajtojë autorja sidomos fatin e atyre që për lirinë e Vlorës, si pjesë e pandarë e atdheut, nuk kursyen kokën. Lufta u mori atyre gjymtyrë të tjerë duke i lënë madje edhe të paaftë për të punuar:

*Po këta që mbenë gjallë,  
mbenë gjallë e të gjorë,  
kush pa këmbë e kush pa dorë,  
qysh do të jetojnë vallë?*

*Gjith këto dhe këta  
janë gjith' nga ata,  
nga ata që u tha Vlora:  
Nëma kokën dhe e dha...*

*Turp i madh, për perëndi,  
unë, tin edhe aji  
për nderim të atij gjaku  
qysh e lëmë e qan bonjaku?*

---

1) Shpat mali pranë Dukatit ku më 29 maj 1920 u mor vendim për shpërthimin e kryengritjes së armatosur kundër imperialistëve italianë, të cilët vazhdonin të mbanin të pushtuar Vlorën dhe disa treva të tjera shqiptare.

Poetja u bën thirrje bashkatdhetarëve që të mos kursejnë asgjë për familjet e atyre që na falën lirinë e Vlorës. Vjersha përfundon me vargjet:

*Hape dorën, hape dorën!  
për ata që fal' Vlorën,  
makari fali ca gur  
sa t'u bëhet një qivur*

Në vitet 1921-1924 filloi një përleshje e ashpër klasore midis forcave përparimtare e reaksionare për problemin e pushtetit. Masat punonjëse dhe shoqëritë përparimtare kërkonin ta vinin vendin në rrugën e demokratizimit dhe të përparimit, kudo u krijuan shoqëri demokratike. Edhe gratë shqiptare filluan ta thoshin më me forcë fjalën e tyre për përparimin e atdheut.

Në krye të këtij vrulli të madh të luftës së masave për liri e demokraci u përfshi edhe Marigo Posio, e cila vuri tërë forcat e saj për riorganizimin e shoqërisë së grave «Shpresa kombëtare», veprimtaria e së cilës ishte ndërprerë për shkak të Luftës së Parë Botërore, ishte ndërprerë në ato çaste që ajo duhej të forcohej, ishte ndërprerë në kohën që ajo ende nuk i kishte dhënë sa duhet frytet e punës së saj.

Kohët ishin mjaft të vështira. Marigosë i duhej të trokiste përsëri derë më derë dhe të priste e të përcillte në shtëpinë e saj gratë atdhetare të Vlorës. Ajo kërkoi ndihmën e një shoqërie të vërtetë patriotike që vepronte në atë kohë në Vlorë, shoqërisë «Mbrojtja kombëtare», e cila botonte dhe gazetën me të njëjtin emër. Në krye të saj ishin atdhetarë të shquar, si: Jani Minga, dom Mark Vasa etj. dhe bashkëpunonin me këtë organ dhe Halim Xheloja, at Shtjefën Gjeçovi etj.

Në gazetën «Mbrojtja kombëtare» lexojmë këtë thirrje bërë nga disa gra organizatore të shoqërisë «Shpresa kombëtare»: «Të dielën e kaluar u mbledhën ca zonja në shkollën e çupave për bisedime, për formimin e shoqërisë «Shpresa», por duke mos qenë në një numër të mjaftë, sa për të zgjedhur ligjisht një pleqësi,

bëmë mejtin për thirrjen e përgjithshme që të bëhet mbledhja gjerësisht të dielën 16 janar, ora 2 pas dreke.

O burra, të ndershëm, këshilloni ju fëmijën (Lexo: gruan — Z.B), thuaj që të mos mungojë të dielën nga shoqëria e vet, pse atdheu pret shërbime të mëdha nga gruaja shqiptare».<sup>1</sup>

Krijimin e kësaj shoqërie demokratike, që kishte për qëllim themelot lartësimin e gruas, e përshëndeti shoqëria «Mbrojtja kombëtare». Në të thuhet: «Shoqëria «Mbrojtja kombëtare» gëzohet!, gëzohet! dhe pse hollë kupton nga do t'i vijë kombit tonë një ndryshim rrënjësor në përparimin qytetruer. Ne, burrat, gjithnjë ua kemi hedhur fajin prindërve tanë, që nga padituria e tyre na rritën të verbër, po nuk e mejtojmë që edhe ata që do të vijnë pas neve, po qe se nuk përkujdesemi, do të na mallkojnë shpirtin, pse i lamë në errësirë.

Ati është drejtonjësi dhe udhëheqësi i fëmijës. Mëma është shikuesja dhe rritësjë e çilimiut, është themeli i moralit të parë shtëpiak, të cilën pjella e trashëgon si një natyrë të dytë dhe me qëndresë e heq me vete deri në gropën e varrit. Jeta praktike na rrëfen se mësimi i Nënës është më i fuqishëm nga mësimet e çdo shkolle, andaj lypset që nëna të dajë mirë detyrën e saj që t'ia kalli përllimisht fëmijës dhe shtëpisë».<sup>2</sup>

Me përpjekjet e Marigosë dhe të shoqeve të saj u riorganizua me program më të përhapur shoqëria e grave. Një nga vendimet e rëndësishme të mbledhjes ishte botimi i gazetës «Shpresa kombëtare», numri i parë i së cilës doli më 6 shkurt 1921. Drejtoreshë e përgjithshme e gazetës u zgjodh Marigo Posio.

Botimi i gazetës i dhë një shtytje të madhe lëvizjes emancipuese të grave. Por, megjithëse gazeta nuk e pati jetën të gjatë Marigoja nuk reshti së punuari për çlirimin e gruas deri në fundin e jetës së saj, edhe kur njëra pas tjetrës i ranë mbi kokë shumë vuajtje dhe fatkeqësi. Tuberkulozi, kjo sëmundje e tmerrshme për kohën, filloi të brejë mushkëritë e Marigosë e të famil-

1) «Mbrojtja kombëtare», Vlorë, 13 janar 1921.

2) Po aty, 2 janar 1921.

jes së saj. Ajo u detyrua të shkojë për kurim jashtë shtetit duke harxhuar dhe pasurinë e saj të fundit. Por, më shumë se për veten, ajo interesohej për jetën e shëndetin e miqve dhe të atdhetarëve. Në kartvizitën dërguar nga Vjena më 4.9.1921 Ibrahim Shytit, midis të tjerash, i shkruan: «Kini shumë shumë shëndete nga mua, Ferëniqi dhe të gjithë. Mos na harroni tani që jemi larg, neve gjithnjë i kujtojmë miqtë dhe atdhetarët e mirë».<sup>1</sup>

Vitet po ecnin. Lufta për zhvillim demokratik të vendit në vitet 1921-1924 bëhej gjithnjë më e fuqishme. Kur për arsye ekonomike e shëndetësore nuk mundi ta vazhdonte botimin e gazetës «Shpresa kombëtare», Marigoja e vazhdoi këtë punë me fjalën e saj të zjarhtë.

Por, fizikisht dhe ekonomikisht, nga dita në ditë Marigoja po rrënohej.

Pranvera e vitit 1924 ishte plot tallaze në luftën për demokracinë. Forcat demokratike po i kundërshtonte gjithnjë e më fuqishëm Ahmet Zogu i cili synonte të vendoste diktaturën.

Vrasja e Avni Rustemit elektrizoi si asnjëherë tjetër gjendjen në Vlorë. Në dhjetor të vitit 1920 populli e kishte pritur atë në Skelë plot gëzim e hare se kthehej fitimtar nga Parisi. Kurse tani vite më vonë po e priste në arkivol. Urrejtja e madhe popullore e pleqve dhe e fëmijëve, e nënave dhe bijave s'njihte kufi. Marigoja dhe Ferëniqi organizuan gratë e vajzat për ta pritur me nderime trupin e trimit të shquar.

Një pjesëmarrës i asaj pritjeje të përmortshme shkruan: «Një lumë njerëzish e kurorash mbulonte tej-përtej rrugën Skelë — Vlorë. Në krye të korteut ishin nja 30 vajza të veshura me fustane të bardha, me kryet të mbështjellë me lahurë të zinj që u vareshin prapa, gjer në mes të shpatullave».<sup>2</sup>

Marigoja, që dikur i kishte thurur një poezi aktit trimëror të Avniut, atë ditë ishte e mbushur plot urrej-

1) Kujtimet ruhen në familjen e I. Shytit.

2) Shefqet Musaraj, almanaku letrar «Vlora, Vlora!», nr. 4.

tje. Ky hidhërim popullor përshpejtoi zhvillimin e ngjarjeve që çuan në fitoren e Revolucionit të Qershorit.

Marigoja ishte përkrahëse aktive e këtij Revolucionit. Bastri Mullaj për këtë ngjarje kujton: «Marigoja ka qenë përkrahëse e Revolucionit të Qershorit dhe e Qeverisë së Fan Nolit. Më kujtohet që ka mbajtur një fjalë të zjarrtë e patriotike mbi varrin e Avniut».<sup>1</sup>

Njoftime për këtë fjalim japin dhe gazetatat e kohës. Beqir Sinani, pjesëmarrës i Revolucionit të Qershorit të vitit 1924, shkruan: «Marigo Posio vazhdoi të jetë në radhën e luftëtarëve për një Shqipëri demokratike dhe më 30 prill 1924 foli me këtë besim, në emër të grave tona, mbi varrin e udhëheqësit popullor Avni Rustemi».<sup>2</sup>

## 7. E PËRÇMUAR NGA REGJIMI, E DASHUR PËR POPULLIN

Revolucioni i Qershorit 1924 triumfoi. U krijuan disa kushte më të mira për zhvillimin demokratik të vendit. Atdheu filloi të marrë frymë më lirisht dhe po vihej në rrugën e përparimit. Por çifligarët e përmbysur me në krye mbrojtësin e zellshëm të tyre, Ahmet Zogun, nuk mund të pajtoheshin me gjendjen e re. Revolucionit e bëri beun e Matit të hidhej në prehrin jugosllav, të cilët nuk mund të mos e ndihmonin Zogoloviçin — siç filloi ta thërriste populli. «Imperialistët anglezë e amerikanë dhe qeveritë reaksionare të Beogradit dhe Athinës vendosën ta rrezonin qeverinë e Fan. Nolit me anën e forcës dhe të shtypnin revolucionin».<sup>3</sup> Ia besuan këtë detyrë kryesisht qeverisë jugosllave. Në fillim të dhjetorit 1924 në Romë u bë një takim midis Musolinit dhe ministrit të jashtëm

1) Kujtime dhënë autorit.

2) Mësuesi, 21 gusht 1971.

3) «Historia e Shqipërisë» vëll. III, Tiranë 1984, f. 303.



të Jugosllavisë, të cilët u morën vesh për të përkrahur planin e sulmit kundër Shqipërisë.

Reaksioni i jashtëm, i ndihmuar fuqimisht dhe nga ai i brendshëm, bënte që më 24 dhjetor 1924 trupat kundërrevolucionare të hyjnë në Tiranë dhe brenda pak kohe të pushtojnë tërë Shqipërinë. Kështu që «forcat e bashkuara të reaksionit imperialist dhe të reaksionit shqiptar, jugosllav e grek e shtypën Revolucionin e Qershorit, lëvizjen e madhe popullore».<sup>1</sup>

Kundërrevolucionin ndillte kudo zi. Në Vlorë erdhën bandat e Taf Kaziut, të cilat plaçkitën shtëpi e dyqane dhe gjatë janarit të ftohtë të vitit 1925 ngroheshin me zjarrin e bankave dhe të orendive të tjera shkollore.

Ata nuk kishin si të harronin dhe fjalën e zjarrtë që mbajti Marigoja mbi varrin e Avniut, udhëheqësit të madh popullor, ndaj e persekutuan atë familje duke i plaçkitur dhe dyqanin.

Përsëri familjen Posio e pllakos një fatkeqësi e re; në mars të vitit 1925 vdes nga tuberkulozi, në lulen e rinisë, Ferëniqi, bija dhe bashkëpunëtorja më e ngushtë e Marigosë, dhe pak kohë pas kësaj vdes edhe vajza më e vogël, Liria, në moshën rreth 15-vjeçare e brejtur nga e njëjta sëmundje.

Marigosë vetë i shpiket një sëmundje tjetër e rrezikshme. Ajo kurohet nga një sëmundje sysh, që, me sa duket, më vonë e çoi në humbjen e të parit. Sëmundjet e njëpasnjëshme e rrënuan plotësisht nga gjendja ekonomike familjen Posio. Marigoja dhe Jovani mbetën keq e mos më keq. Ata u detyruan të strehoheshin te motra e Marigosë në Tiranë, se askush nuk interesohej për jetën e veteranes kombëtare. Regjimi i A. Zogut gjente shpërblime e dekorata për shumë pseudopatriotë, por për Marigonë jo. Revoltën për këtë e gjejmë të reflektuar në shtypin e kohës. Në një artikull të botuar në vitin 1928, shkruhet: «Ka kërkuar me lutje kush e di sa herë një pen-

1) «Historia e Shqipërisë», vëll. II, Tiranë 1965, f. 557.

sion me të drejtë të plotë e në bazë të ligjit përkatës, por asnjëri s'ja ka vënë veshin. Ka trokitur dyer më dyer, por asnjëri se ka dëgjuar, as që ka kthyer kokën ta shohë. Ku janë patriotët të dëgjojnë vajtimet e saja dhe të shohin lotët që derdh e pikëlluar në mes të këtij mjerimi e kësaj agonie? —

Në qoftë se ka ligje për veteranët, ca më fortë duhet të zbatohen për këtë. Është mëkat i pandjerë të lemë një patriot të tillë të vuajë e të lëngojë!»<sup>1</sup>

Në një korrespondencë nga Vlora shkruhet se e vuajtëm dhe ne mjerimin e motrës Marigo, aq sa di-sa prej nesh propozuan formimin e një komisioni, i cili të kujtonte e të siguronte ushqimin e kësaj gruaje të vlefshme (nënvizimi im — Z.B.) Pra, varfëria kishte arritur deri atje sa të kërkohej ushqimi i nevojshëm për atdhetaren e shquar. Në qoftë se nuk do të zbatohet e drejta ligjore e pensionit që i takonte, populli do të krijonte një komision, i cili të mblidhte ndihma për të. Korrespondenca vazhdon: «Mirëpo ligji i veteranëve është bërë me qëllim të lartë dhe duhet të aplikohet më parë në veteranët e vërtetë. Marigo Posion do ta shkruajë historia e gjeneratës së nesërme, sepse «Dielli nuk mbulohet me shoshë dhe kërkohet që sa më parë t'i jepet pension», veteranes, kësaj gruaje kryelartë për të cilën bashkë me të tjerët zemra e shumë vlonjatëve qan në heshtje e me abnegim».<sup>2</sup>

Ndërsa një atdhetar korçar shkruan: « Me të vërtetë jemi habitur, si nuk ja kanë caktuar akoma një pension asaj gruaje, kurse atë duhej ta kishin pensionuar nga të parat» dhe kërkon që Qeveria «jo vetëm t'i japë sa më parë ndihmën e saj, pensionin e merituar që i përket, po dhe i rekomandojmë akoma «që duhet t'i japim caktimin më të madh që cakton ligja sot, se ka nevojë të shërohet...».

Në qoftë se gjer sot s'kanë dhënë më tepër se 15 na-

1) «Gazeta e re», Tiranë, 9 dhjetor 1928.

2) Po aty.

polona në muaj, kësaj zonje duhet t'i japin të njëzetat, se jo vetëm që i meriton po është dhe një nder për ne patriotët».<sup>1</sup>

E gjendur para presionit të masave popullore dhe shtypit përparimtar të kohës, qeveria zogiste u detyrua t'i lidhte një pension. Por nuk kaloi shumë dhe pensioni iu pre. Regjimi i satrapit Zog nuk mund t'ia falte Marigosë luftën që bënte ajo për çështjen kombëtare në tërësi dhe për të drejtat e gruas në veçanti. Ndërsa më 1921 Marigoja botonte në «Shpresa kombëtare»<sup>2</sup> se sikur gratë të kishin të drejtë të votonin, nuk do t'u jepnin asnjë votë kandidatëve që kërkonin shkolla vetëm për djem, një dhjetëvjeçar më vonë gazeta «Vullneti i popullit», që botohej në kryeqytet, shkruante se vajzat duhet të mësojnë, por «jo të ngrihen sa të na kërkojnë nesër të drejtë vote. Kjo e drejtë neve na duket jashtë llogjikës dhe jashtë misionit për të cilin e ka krijuar gruan natyra».<sup>3</sup>

Përsëri protesta për padrejtësinë që po i bëhej veteranes sonë kombëtare, «kësaj të mjere me njëmijë bela mezi iu dha një shpërblim patriotik prej 200 fr. ar mujor, po mjerisht nuk arriti ta marrë përveç një kohe të shkurtër. ...Po është mëkatë... të harrosh therrorët e kombit».<sup>4</sup>

Jeta e vuri Marigonë poshtë fizikisht. Tashmë ajo ishte e varfër sa përshkruhet dhe pa asnjë mjet për t'u mjekuar. Gradualisht humbi dhe dritën e syve dhe në këtë gjendje vdiq më 23 gusht të vitit 1932.

Qëndrimi mospërfillës që vazhdoi të mbahej ndaj saj prej autoriteteve zyrtare kritikohet nga shtypi i kohës, i cili pohon se po të ishte në një vend tjetër të botës së qytetëruar Marigoja do të ishte çmuar që në gjallëri si një heroinë e lirisë së një populli dhe do të nderohej në atë masë.

1) «Gazeta e re», Tiranë, 6 janar 1929.

2) «Vullneti i popullit», Tiranë, 10 nëntor 1931.

3) Po aty.

4) Po aty.

Marigoja u varros në Zvërnec të Vlorës, pranë varreve të familjarëve të saj. Regjimi zogist «nuk u përkujdes as ta varroste me shpenzimet e shtetit e me nderimet që i takonin, si një pioniere e flamurtarë e atdhetarizmit»,<sup>1</sup> — shkruhet në shtypin e kohës.

Por atë që s'mundi ta bëjë regjimi e bëri populli i Vlorës, i cili e përcolli këtë grua të shquar me nderimet e duhura. «Karvani i vlonjatëve që morën rrugën për në Zvërnec, — kujtonte Ymer Picari, — ishte më i madh se çdo herë tjetër. Pa marrë parasysh vapën e madhe të gushtit ne e përcollëm atë me dhimbje në zemër duke i dhënë lamtumirën e fundit».<sup>2</sup>

Humbjen e saj e vajtoi dhe shtypi i kohës. Duke njoftuar vdekjen e saj një gazetë e quante atë «atdhetarja më e madhe e Shqipërisë dhe shembull për të gjitha gratë shqiptare», «femra revolucionare e lirisë së Shqipërisë», «nëna e vërtetë e lirisë së Shqipërisë».

Më poshtë në nekrologji pohohet se «Marigoja ishte njëkohësisht inspironjëse dhe profeteshë e çështjes së shenjtë të lirisë shqiptare» dhe shprehet bindja se «historia e vërtetë e Shqipërisë do t'i japë meritën që i ka hije, toka e bekuar e Vlorës le ta mbajë me ngashërim në gjirin e saj... dhe valët e detit të Vlorës le ta lëkundin ëmbëlsisht». Kurse një organ tjetër i kohës duke lajmëruar vdekjen «në gjendje shumë të varfër të atdhetares së njohur... e cila trashëgoi trimërinë e grave të vjetra shqiptare që jetën, mundimin dhe pasurinë ia kushtoi çështjen kombëtare, e quan Marigonë «heroinë të idesë kombëtare».

## KREU II

### KRIJIMTARIA PUBLICISTIKE E MARIGO POSIOS

Duke trajtuar veprimtarinë publicistike të njëres nga publicistet e para shqiptare, si për periudhën para dhe pas Shpalljes së Pavarësisë kombëtare, do të për-

1) «Vullneti i popullit», Tiranë, 10 nëntor 1931.

2) Kujtime dhënë autorit.

piqemi që të nxjerrim në pah idetë e autores për problemet e ndryshme politike shoqërore, rëndësinë e kësaj veprimtarie, ndikimi që ajo pati dhe krahas saj ku-fizimet ideore që ishin kryesisht rezultat i kohës në të cilën ajo jetoi.

## 1. MENDIME PËR SHKOLLËN, MËSUESIN DHE GJUHËN SHQIPE

*Djemtë tanë duhet që, në vogëli të rriten shqiptarisht, duhet të njohin gjuhën e tyre.*

Problemi i shkollës dhe i gjuhës shqipe si për të gjithë rilindësit edhe për Marigo Posion ka qenë në qendër të vëmendjes. Nuk mund të bëhej fjalë për zgjimin e ndërgjegjes kombëtare pa shkolla në gjuhën amtare. Edhe ajo i përmbahej idesë së shprehur nga Kostandin Kristoforidhi se «ndë mos u shtroftë gjuha e shqipes edhe sot, mbë këtë ditë, nuk do të shkojnë shumë vjet, edhe nuk do të ketë më Shqipëri».1.

Marigoja, sikurse mëmëdhetarët e tjerë, pushkën dhe penën e kanë bashkëlufëtare të së njëjtës llogore. Në lidhje me këtë shoku Enver ka theksuar: «çlirimi i Atdheut nga okupatorët ishte i lidhur me fitoren e diturisë. Rilindësit tanë e konsideronin diturinë dritë, sepse me anë të asaj do të shpërndahej errësira që kish pllakosur popullin tonë gjatë shekujve, sepse ajo do të çonte lart ndërgjegjen dhe patriotizmin e shqiptarit, sepse ajo, e bashkuar me pushkën do të konsolidonte pavarësinë e fituar dhe do të sillte përparimin dhe begatinë e Atdheut».2

1) AQSH i RPSSH, Fondi K. Kristoforidhi, d.11.

2) Enver Hoxha, Vepra, vëll. 61, f. 251.

Marigoja si vazhduese e mendimit dhe e veprës së rilindësve tanë të shquar, synonte të ndriçonte mendjen e bashkatdhetarëve dhe t'i përgatiste ato për detyrat e mëdha që i dëlnin përpara. Ajo ishte e mendimit se këtë detyrë mund ta kryente shkolla, prandaj shkruan: «Vlonjatët kanë qenë gjithnjë liridashës, kanë dashur kurdoherë përparim. Dëshira më e madhe e vlonjatëve ka qenë të hapurit e shkollës shqip, të përdorurit e gjuhës sonë... Vetëm me shkollat e me mësimin e gjuhës së stërgjyshërve tanë do të arrijmë të shporrim sëmundjen e vendit, padijen»<sup>1</sup>

Shkolla shikohet prej saj si njet i domosdoshëm për forcimin e unitetit kombëtar, ndaj në të njëjtin shkrim autorja vazhdon: «Vetëm me anën e këtyre veglave do të mundim të sjellim bashkimin dhe vëllazërimin, nevojat më të mëdha për të cilat s'kemi pushuar së bër-tituri. Duhet, pra, që gjithë kujdesi jonë, mundimet tona të përmbliidhen në një çështje: në çështjen e shkollës. Shkolla, shkolla kudo o vëllezër shqiptarë!»<sup>2</sup>

Në të njëjtin organ, në një artikull tjetër Marigo Posio e trajton më gjerësisht dhe në mënyrë më të plotë nevojën e shkollës edhe nxit vlonjatët që të ndër-marrin hapa praktikë për hapjen e shkollës në gjuhën shqipe. Në artikullin e saj, midis të tjerash, lexojmë: «E dimë fort mirë sa vlen për ne shkolla. Vetëm kjo vegël do të nxjerrë njerëz me ndjenja të natyrshme, do të mërgojë padijen e vështirë të vendit tonë»<sup>3</sup>.

Marigoja synon që me anën e shkollës shqipe t'u presë rrugën propagandave të huaja që me aq forcë vepronin në Vlorë dhe në të gjithë Shqipërinë. Me anën e shkollave në gjuhën turke, greke e italiane, pushtuesit dhe shovinistët fqinjë helmonin ndërgjegjen kombëtare të brezit të ri dhe të një pjese fanatike. Për të pasur sukses në këtë drejtim autorja vazhdon: «Me anën e shkollës kemi për të filluar edhe ne propagandën

1) «Korça», Viti i I, nr. 18, 22 tetor 1909.

2) Po aty.

3) «Korça», viti I, nr. 20, 5 nëntor 1909.

tonë për të çrrënjosur mendimet e ndryshkura të atyre që e kanë për mëkat të madh të quhen shqiptarë». Është, pra, nevojë që të fillojmë edhe ne lëvizjen thjesht kombiare, të numërohemi edhe ne për njerëz të qytetëruar. Është turp i madh që të bëjmë të huaj zotër në shtëpitë tona. Duhet të rrëfëhemi te këta që edhe ne të jemi njerëz me vullnet, me vetënjohje. Po kjo lëvizje, kjo propagandë bëhen vetëm me arsimin dhe përfytyrimin e ri që mund të marrim me anën e shkollës, të diturisë dhe jo me të përdorurit shtrëngim (Violation) dhe egoizmit»<sup>1</sup>.

Ajo kërkon nga bashkëluftëtarët që «të mos vonojnë më, të kujdesen me çdo mënyrë për të hapur një shkollë...» dhe të mos mbetën në premtimet që kanë bërë dy bejlerë të Vlorës, të cilët ishin zotuar prej kohësh se do të ndihmonin materialisht për hapjen e shkollës, por në fakt nuk jepnin gjë. Shkrimi përfundon: «O burrani vlonjatë, përpiquni për dituri»<sup>2</sup>

Meqë hapja e shkollës shqipe të Vlorës po vonohej, në një korrespondencë ajo u bën thirrje disa atdhetarëve të shquar vlonjatë që «të marrin përsipër këtë iniciativë e të bëhen ata udhëheqësit e kësaj vepre... Kemi pra shpresë që të dashurit tanë do të marrin nën vështrim kërkesat tona edhe do të kënaqin dëshirën që detyrimisht ndiejmë, e cila dëshirë është dhe duhet të jetë e përgjithshme.»<sup>3</sup>

Por shkolla merr jetë në radhë të parë nga puna e mësuesit, ndaj ajo në shkrimet e saj kërkonte që këtë detyrë t'a kryejnë njerëz të aftë e që në radhë të parë të jenë mëmëdhetarë të mirë. Në këtë çështje ajo nuk mund të mos ngrihet kundër atyre arsimtarëve që u shërbejnë dredhive të politikës së huaj. Krahas tyre kritikon dhe përfaqësuesit e hierarkisë fetare e vetë fanatikët që bien në kurthin e tyre «të cilët zgje-

---

1) «Korça», viti I, nr. 20, 5 nëntor 1909.

2) Po aty.

3) «Korça» viti I, nr. 26, 13 dhjetor 1909.

dhin për mësonjës njerëz që s'kanë ndjenja kombëtare...»<sup>1</sup>

Marigoja kërkonte që me detyrën e lartë të mësuësit të merreshin atdhetarë të shquar si Jani Minga, i cili për veprimtarinë e tij kombëtare ishte pushuar nga puna. Ajo shkruan: «Andaj duke kthyer kujdesin e bashkëqytetarëve tanë në të hapurit e një shkolle të mbarë, i këshillojmë që të zgjedhnin për drejtor atdhetarin Jani Minga, shqiptar i provuar, i cili ndodhet pa vend se shkolla greke e pushoi nga puna ngaqë është shqiptar.»<sup>2</sup>

Në artikullin «Shembulla e një shqiptarke»<sup>3</sup> Marigoja përshëndet veprimin atdhetar të Polikseni Spathiotu, shqiptarkë nga Elbasani, që kryente detyrën e mësueses në shkollën femërore greqisht të Vlorës. Inspektori i konsullatës greke si vizitoi «shkollat e këtuashme, mbeti shumë i hidhëruar kur pa nxënëset (vashat) në vend që t'i gjejë greke, siç shpresonte, i gjeti krejt shqiptarka». Kur vajzat iu përgjigjën «Jemi shqiptarka» ai u ndodh para një të papriture dhe doli nga klasa tërë nervozizëm duke mos përshëndetur as mësuesen. U pa të këmbente fjalë qortuese vetëm me drejtoreshën «së cilës i tregoi hidhërimin e tij».

Duke lavdëruar punën e mësueses Polikseni, kësaj «çupe me ndjenja të atdhetarta dhe të fisshme», Marigoja shpreh bindjen se gjithë populli me kënaqësi të madhe admiron «guximin dhe trimërinë e kësaj vajze mëmëdhetare».

Marigoja gjen rast këtu të vlerësojë lart veprën patriotike të femrave duke ftuar edhe burrat që të marrin shembull nga veprime të tilla: «E përhirojmë nga zemra shqiptarkën e ndershme për veprimtarinë e lartë me të cilën shoqëron ndjenjat e saj dhe e dorëzojnë porsia shembull të gjallë për shqiptarkat dhe ca më tepër për burrat shqiptarë, të cilët në sjelljen e hijshme

1) «Korça», viti I nr. 26, 24 tetor 1909.

2) Po aty, 24 tetor 1909.

3) Po aty.



të kësaj zonjëze gjejnë një shkak të madh për të punuar vepra të shkëlqyera dhe të dobishme për kombin tonë.»

Në fund të shkrimit autorja paralajmëron të pagdhendurit dhe tradhtarët që të hapin sytë mirë, të marrin udhën e mbarë, udhën e nderit.

Marigo Posio, duke goditur pa mëshirë një rast kur dy shqiptarë u grindën keq se i pari përshëndeti greqisht, kurse tjetri ia ktheu shqip, pohon se ai që përçmon gjuhën e tij ka poshtëruar veten e vet. Ajo kritikon ata që «e kanë për mëkat të madh të përshëndetin tjetrin në gjuhën e tyre», duke e cilësuar si qesharake atë që pasi mbarojnë përshëndetjen «zënë e flasin pastaj në gjuhën e tyre shqip!»

Por ajo në këtë veprim nuk mohon aspak nevojën e mësimit dhe të përdorimit me vend të gjuhëve të huaja, madje e quan si një veti të mirë të shqiptarëve dëshirën për t'i mësuar ato. Marigoja shprehet se «Duhet t'i japim gjuhës sonë pushtetin dhe bukuritë që i nevojiten. Kështu, pra, të përshëndeturit në gjuhën shqipe të shqiptarit është më i ëmbël dhe më i hijshëm. Sa për mëkatën le ta lëmë mënjanë, ose më mirë le të na hidhet neve përsipër»<sup>1</sup>

Me forcë të madhe ajo shtroi problemin e mësimit të gjuhës shqipe në shkollë. «Djemtë tanë, — shkruan ajo, — duhet që që në vogëli të rriten shqiptarisht, duhet të njohin gjuhën e tyre»<sup>2</sup>.

Kur xhonturqit e panë se nuk mund ta ndalonin dot më shkrimin e gjuhës shqipe, filluan të përdorin një dredhi tjetër, atë të shkrimit të saj me alfabet arab, pa marrë parasysh se kjo çështje qe zgjidhur në Kongresin e Manastirit. Ata gjetën përkrahjen e elementëve turkomanë, të krerëve të klubit shqiptar të Stambollit dhe të 14 të ashtuquajturve deputetë shqiptarë të cilët, siç pohon shtypi i kohës, nuk dinin asnjë fjalë shqip. Ata i kërkuan mexhlizit (parlamentit turk) «në

1) «Korça», 18 dhjetor 1909.

2) Po aty.

emër të shqiptarëve, që gjuha shqipe të shkruhej në alfabetin arab.

Për këtë qëllim myftiu i Manastirit, Rexhep Nuredini, i dërgoi partisë turkomane dhe klubit xhonturk të Vlorës një broshurë që përmbante transkriptimin përkatës të shkronjave turqishte për të shkruar gjuhën shqip. Kundërshtimi popullor në Vlorë ishte kaq i madh sa që qytetarët vendosën të mos i çojnë djemtë e tyre në shkollë, në qoftë se ai (alfabeti arab — Z.B.) futet në atë të këtushmen,<sup>1</sup> — raporton nënkonsulli austro-hungarez i Vlorës.

Në këto rrethana, si luftëtare e zjarhtë për shkrimin e gjuhës shqipe në alfabetin kombëtar, Marigoja proteston kundër atyre të cilët kërkojnë që shqipja të shkruhet në alfabete të huaja. Kjo urrejtje arrin deri në sarkazëm. Në një artikull ajo shkruan: «Duhet hequr për shkrimin e gjuhës shqipe me shkronja turqishte. Duhet bërë kabull marrëzia e këtyre? Që t'ju them të drejtën, të dashur këndonjës, mua më vjen për të qeshur sa herë mëjtohem për shpikjen e këtyre zotërinjve! Sa mençuri të madhe! Po harruan këta zotërinj që shqiptarët janë të zgjuar, harruan se shkronjat me të cilat kanë qenë shkrojtur, shkruhet edhe do të shkruhet shqipja, shqiptarët i kanë shenjtëruar! Harruan që shkronjat e bukura e të këndshme me të cilat përçfaqim mendimet tona të shqiptarta janë për ne shqiptarët e vërtetë të shtrenjta? Nuk u mentuan pakëz që me shpikjen e paudhësisë bëjnë një «deliktun» të madh të gjuhës shqipe. Nuk u mejtuan se Shqipëria ka për t'i mallkuar këta të çmendur për çnderimin që kërkojnë t'i bëjnë?»<sup>2</sup>

Marigoja duke pohuar se çështja e abecesë është problem themelor i ditës «ngjatjeton me gjithë zemër» ata deputetë atdhetarë shqiptarë që «u treguan vendin atyre zotërinjve, të cilët nga historia e gjuhës dhe nga

1) Arkivi i Institutit të Historisë (AIH). Fondi i Arkivit të Vjenës, dosja 20-I-180, viti 1910.

2) «Korça», nr. 33, 4 shkurt 1910.

filologjia s'kanë pikën e haberit».<sup>1</sup> Përshëndet, gjithashtu, studentët shqiptarë të Stambollit, të cilët fisnikërisht iu kundërvunë deputetëve turkomanë dhe u bënë thirrje «që të kujdesen për të mbrojtur gjuhën tonë nga çdo rrezik» e «të përhapin dritën e diturisë në çdo vend». Shkrimi përfundon: «Shqipëria pret shumë gjëra nga djelmëria. Atëherë guxim e përpara kurdoherë»<sup>2</sup>.

## 2. BASHKIMI I POPULLIT — ÇELËSI I ARTË I TË GJITHA FITOREVE

*Çdo shqiptar me ndërgjegje, me  
ndjenja kombëtare, duhet lehtëzi  
ta kuptojë që bashkimi për ne është  
fitimi më i madh që mund të ëndë-  
rrojmë, përçapja e parë në udhë të  
arsimit, të qytetërimit.*

Bashkimi — çelësi i artë i të gjitha fitoreve. Ky problem i përhershëm nuk mund të mos tërhiqte vëmendjen edhe të Marigosë. Si vazhduese e mendimeve të rilindësve tanë të mëdhenj, ajo iu kushtua kësaj çështjeje. Si korrespondente e rregullt e gazetës «Korça», Marigoja shkruante për ngjarjet dhe për problemet më të mprehta që shqetësonin atdhetarët vlonjatë dhe që ishin në të njëjtën kohë edhe shqetësimet e të gjithë shqiptarëve të vërtetë. Në artikullin «Bashkimi»<sup>3</sup> ajo shpreh shqetësimin e saj për gjendjen që po kalonte vendi, që rrezikohej të copëtohej më tej. Ajo shpreh habinë e saj me ata shqiptarë, të cilët «përçfaqnin një vërtetim të hidhëruar për ne» dhe kër-

1) «Korça», nr. 33, 4 shkurt 1910.

2) Po aty.

3) Po aty.

kon që t'i japin «një drejtim të mbarë çështjes sonë duke kthyer vështrimet në një horizont të ri».

Marigo Posio qorton ata që përpiqen «të marrin udhën e kundërshtarëve duke prurë ndalime edhe pen-gesa të pakapërcyera atje ku na duhet bashkimi dhe dashuria.»<sup>1</sup>

Duke shtjelluar vlerën e madhe e të pazëvendësueshme që ka bashkimi i popullit, artikullshkruesja vazhdon: «Çdo shqiptar me ndërgjegje e me ndjenja kombëtare duhet lehtazi të kuptojë që bashkimi për ne është fitimi më i madh që mund të ëndërrojmë, përçapja e parë në udhë të arsimit, të qytetërimit»<sup>2</sup>

Por cilat ishin problemet themelore ku duhej të përqendrohej ky bashkim? Kësaj pyetjeje atdhetarja e zjarrtë i përgjigjet: «Po s'duhet harruar që neve kemi nevojë jo vetëm për bashkim zemre, por nevojë për të përnjëshmuar mejtimet tona, duke vazhduar të gjithë një qëllim, i cili tani për tani është përmirësimi i gjendjes sonë kombëtare dhe lulëzimi i gjuhës sonë.»<sup>3</sup>

Pra ngritja e ndërgjegjes kombëtare dhe shkrim-këndimi i gjuhës shqipe, ishin për të problemet më të qenësishme të kohës.

Patriotja kërkon që çështjet kombëtare të preokupojnë mendjet e çdo shqiptari. Ajo qorton ata njerëz që nuk mendojnë «kthjelltësisht» dhe drejtësisht. Në shtjellim të këtij mendimi autorja vazhdon: «Tani koha na dëfton një detyrë të lartë, të cilën duhet ta mbushim pa vonuar. Tani duhet të shtrëngojmë bashkimin, të shtojmë dashurinë te njëri-tjetri duke punuar vepra të pëlqyeshme, të frytshme për kombin tonë.»

Në fund ajo shtron nevojën për të qenë vigjilentë ndaj armiqve dhe kritikon ata që nuk meritojnë emrin e nderuar shqiptar. «Në qoftë se bashkimi na mungon, në qoftë se humbasim kohën kotësisht edhe s'rri-

1) «Korça», nr. 33, 4 shkurt 1910.

2) **Po aty.**

3) «Korça», nr. 13, 4 shkurt 1910.

më squar për t'u bërë ballë kundërshtarëve qysh do mundemi të shpëtojmë nga krizat që na sjellin disa njerëz pa ndjenja, pa vetëdije, të cilët është turp t'i quajmë shqiptarë».<sup>1</sup>

Kësaj teme i është rikthyer edhe herë të tjera, duke shtruar përherë problemin e bashkimit kombëtar.

### 3. GAZETA «SHPRESA KOMBËTARE»

#### a. Përmbajtja dhe qëllimi i gazetës

Publicistika jonë e viteve të paraçlirimit është dëshmi e luftës së madhe e të papajtueshme që ka bërë populli ynë në fushën e përparimit politik, ekonomik dhe shoqëror.

Zhvillimi i gazetarisë sonë në gjysmën e parë të dhjetëvjeçarit të tretë të këtij shekulli karakterizohet nga një zhvillim disi i vrullshëm e plot kontradikta të brendshme, si rezultat i kushteve konkrete historike-shoqërore të Shqipërisë. Shtypi ynë përparimtar është jo vetëm pasqyrë e kohës, por ai ka shërbyer si mobilizues i masave të gjera popullore në luftën për përparim shoqëror, i ka brumosur masat me idetë për liri e pavarësi.

Njohja dhe studimi mbi bazën e metodologjisë marksiste-leniniste i shtypit tonë është një ndihmesë me vlerë në ndriçimin e historisë, në historinë e zhvillimit të mendimit politik e shoqëror, në historinë e traditave më të ndritura atdhetare, luftarake dhe kulturore të popullit tonë.

Në lidhje me rolin e madh të fjalës së shkruar shoku Enver Hoxha ka theksuar: «Fjala e shkruar do të ishte ai rrip transmisioni i rëndësishëm për te masat, nëpër të cilën do të rridhnin si përrua idetë çlirimtare dhe zjarri i pashuar i njerëzve më të përparuar të kohës. Ajo do të shpërndante errësirën e do të mbilte diturinë, do të zgjonte e kaliste ndjenjat kombëtare në zemrat e shqiptarëve, do t'i edukonte, do t'i

1) «Korça», nr. 13, 4 shkurt 1910.

lidhte ato dhe do t'i bashkonte më fort masat, do t'i hidhte ato në luftë për liri».<sup>1</sup>

Në vitet 20-të shtypi ynë përparimtar ka luajtur një rol të dorës së parë në edukimin atdhetar dhe për përhapjen e ndjenjave patriotike midis popullit. Por, natyrisht, vlerësimi i këtyre organeve duhet bërë duke pasur parasysh dhe kushtet në të cilat kanë punuar e vepruar gazetarët tanë patriotë dhe idetë e tyre duhen vështruar të lidhura ngushtë me shkallën e zhvillimit të shoqërisë shqiptare bashkëkohore.

Një nga meritat kryesore të shtypit tonë përparimtar të viteve 1921-1924 është fakti që ai nuk u kufizua vetëm me formimin e ndjenjave kombëtare, por luftoi aktivisht edhe kundër obskurantizmit fetar, për dritë, arsim, demokraci dhe liri shoqërore.

Kjo ishte periudha kur në plan të parë dilnin probleme të zhvillimit ekonomiko-shoqëror të vendit, kur kishte kontradikta të thella klasore në gjirin e shoqërisë së kalbur feudo-borgjeze, kur lufta midis tyre dhe forcave përparimtare të përfaqësuar nga elementë demokratë borgjezë, të cilët mbështeteshin nga masat popullore, ishte e ashpër.

Një nga organet përparimtare të shtypit tonë, që ka luajtur një rol të rëndësishëm në përpjekjet e popullit tonë sidomos të gruas shqiptare në luftë për emancipimin e saj, është gazeta «Shpresa kombëtare», organ i shoqërisë homonime të grave vlonjate.

«Shpresa kombëtare» zë një vend të rëndësishëm nderi midis organeve të tjera të shtypit tonë të parçlirimit sepse është gazeta e parë e një shoqërie demokratike përparimtare dhe patriotike grash. Ajo është gazetë që u krijua prej grave, në të shkruanin kryesisht gra, drejtohej dhe administrohej prej grave. Drejtoreshë e përgjithshme e saj u zgjodh kryetarja e shoqërisë «Shpresa kombëtare» patriotja e mirënjohur Margito Posio, e cila diti të grumbullojë rreth vetes dhe gazetës gratë demokratike dhe përparimtare të Vlorës, duke vënë në lëvizje si bashkëpunëtore të këtij organi

1) Enver Hoxha, Vepra, vëll. 24, f. 10.

dhe shumë gra shqiptare që vepronin jo vetëm në Shqipëri por edhe jashtë saj.

Numri i parë i gazetës doli më 6 shkurt 1921. Ajo shtypej në katër faqe me format të vogël, me dy a më shumë kolona, me letër ngjyrë trëndafili dhe të gjelbër, që simbolikisht përfaqësonin gjakun, ngjyrën e flamurit, paqen dhe lulëzimin që kërkonin gratë shqiptare.

Vetë titulli i shkruar në formën e një gjysmëharku në ngjitje jep idenë e lartësimit në të ardhmen të kombit dhe gruas shqiptare. Një shqiponjë krahëhapur në fluturim tregon në mënyrë simbolike se Shqipëria dhe gratë e saj kishin filluar rrugën e përparimit, rrugën e lirisë.

Formës, si e lidhur me përmbajtjen dhe e vënë në shërbim të saj, i është kushtuar vendi që i takon për ta paraqitur organin sa më dinjitoz, për ta bërë sa më tërheqës e për pasojë për të edukuar sa më mirë masën e lexuesve. Duke i kushtuar kujdesin e duhur formës redaktoret Marigo dhe Ferëniqi Posio, e kuptonin atë si të lidhur pazgjidhshmërisht me përmbajtjen. Duke parë se forma ka të bëjë jo vetëm me paraqitjen e jashtme, por edhe gjuhën e pasur e të kuptueshme dhe stilin komunikues, nënë e bijë, bënë çmos që organi të dilte sa më tërheqës, jo vetëm nga përmbajtja por dhe nga trajta e jashtme, si: shkrimi i titujve, nëntitujve, organizimi i rubrikave, faqosja etj.

Gazeta ishte e përdyjavshme; numri 6, i cili doli më 25 maj, është numri i fundit që ruan dhe Biblioteka Kombëtare në Tiranë, dhe, me sa duket, ky është numri i fundit.

Në numrin e fundit, që doli me vonesë, lexojmë se ai numër u vonua «për arsye të sëmundjes së drejtoreshës dhe të redaktores.»<sup>1</sup>

---

1) «Shpresa kombëtare», 25 maj 1921. T. Selenica në librin «Shqipëria më 1927» duke renditur organet e shtypit shqiptar, për vitin e botimit të kësaj gazete shënon 1921-1922. Mendojmë se kemi të bëjmë me një pasaktësi të tij, por nuk përjashtojmë mundësinë që numrat e tjerë të mos gjenden tani për tani.

Gazeta «Shpresa kombëtare» doli në një mjedis me tradita shumë të shëndosha atdhetare dhe pas një hovi të madh popullor që ngjalli sidomos fitorja historike e vitit 1920 mbi imperialistët italianë. Një rol të rëndësishëm në përparimin dhe frymën e lartë luftarake dhe militante të gazetës në çështjet kombëtare ka luajtur dhe fakti që në krye të saj qëndronte një patriote me një veprimtari shumë të madhe patriotike dhe me një kulturë të gjerë për kohën. Kjo ishte Mari-go Posio, e cila kishte thyer normat kanunore dhe ishte rreshtuar krahas burrave më të nderuar në veprimtarinë patriotike.

Një rol të dorës së parë në këtë gazetë ka luajtur dhe bija e saj, Ferëniqi, e cila ishte e ngarkuar me detyrën e redaktores.

Në kohën që veproi gazeta «Shpresa kombëtare» atdhetarët vlonjatë ishin organizuar në një shoqëri thellësisht patriotike e përparimtare, në «Mrojtjen kombëtare», që i dha një ndihmë të drejtpërdrejtë si shoqërisë ashtu dhe gazetës «Shpresa kombëtare».

Dalja e kësaj gazete u vlerësua me të drejtë, si një ndodhi me rëndësi të madhe, jo vetëm për Vlorën por edhe për tërë gratë e vendit.

Problemet që ngrihen nëpër faqet e kësaj gazete janë të shumta, të ndryshme dhe të larmishme, por ne mendojmë t'i trajtojmë ato të ndara në këto çështje themelore:

1 «Shpresa kombëtare» për përparimin, arsimimin dhe zgjimin e gruas shqiptare.

2 Gjithë përparimi dhe zhvillimi i femrës t'i shërbejë lartësisht të Atdheut.

3 Gruaja si bazë e familjes, edukatore e fëmijëve dhe amvisë e mirë.

4 «Shpresa kombëtare» — organizatore kolektive e grave shqiptare.

a «Shpresa kombëtare» për përparimin, arsimimin dhe zgjimin e gruas shqiptare.

Qëllimi i daljes së gazetës «Shpresa kombëtare» është



për të zbatuar programin e shoqërisë homonime, i cili jepet që në numrin e parë.

— Përparimi, arsimimi dhe zgjimi i femrës shqiptare.

— Ndhimja për çdo qëllim kombëtar.

— Stërvitja e vajzave në shkollë dhe «të ndihmojë me të hollat e saj vajza të varfëra të vazhdojnë mësimet e tyre në shkollat e larta.»<sup>1</sup>

Megjithëse ky organ pati pak numra, në të u lëvruan me sukses disa gjini të publicistikës. Në të vend kryesor kishte kryeartikulli, si formë e shkrimit programatik. Ai nuk mungoi në asnjë nga numrat dhe problemet më thelbësore janë trajtuar në kryeartikujt e gazetës. Në ta është zbrëthyer dhe popullarizuar qëllimi dhe programimi i gazetës homonime.

Në kryeartikullin e botuar në numrin e parë me titull «Lipset kujdesi për femrë», jepet programi i gazetës:

«Programi i fletores «Shpresa kombëtare» do të jetë shtytja e paparë në përparimin dhe lartësimin moral dhe material të femrës shqiptare duke u përpjekur me të gjitha fuqitë që t'i forcojë ato zakone të mira, që deri më sot i kanë mbajtur të larta e të lavdërueshme femrat tona, si dhe të thithin si bleta nga ato të botës që mund të pajtohen me të vetat, për plotësimin dhe mbaresën e detyrës së lartë që femra ka kundrejt shtëpisë, shoqërisë dhe mëmëdheut.»<sup>2</sup>

Këtu na del qartë se Marigoja nuk ishte as ksenofobe, as ksenomane.

Duke trajtuar në mënyrë të drejtë problemin e traditës sonë, nga e cila duhet ta ruajmë dhe ta zhvillojmë të mirën, të renë, kombëtare, përparimtare e të marrim dhe nga popujt e tjerë atë që është pozitive. Programi bën fjalë dhe për pamundësinë që ka gruaja shqiptare për të ecur përpara nga mungesa e shkollave, nga ekzistenca e tyre në gjuhë të huaj dhe veça-

1) «Shpresa kombëtare», 6 shkurt 1921.

2) Po aty.

nërisht nga lufta që bënin ato për shkombëtarizimin e vëndit tonë. «Shkelën bota në vëndin tonë; deshën të rra shkulin e të na hiqnin zakonet tona, për të na kallur të tyret, nuk qenë të zotët... ikën të ndjekur, por u përpoqën që të na dëmtojnë duke i thënë botës së qytetëruar që kombi ynë është barbar, nuk është i zoti i qytetërimit; femrën e ka kafshë, shtëpinë e ka burg, burrat i ka pis». Artikullshkruesja ka qëllim që të ngjallë urrejtjen popullore ndaj armiqve të jashtëm, të cilët bënin çmos për të përçmuar shqiptarët dhe për të përlligjur misionin e tyre «kulturor» ndaj popullit tonë.

Duke shprehur bindjen se e drejta fiton, artikullshkruesja njeh edhe të metat që vërehen te ne dhe shpreh besimin se ato do t'i rregullojmë vetë, me forcën tona. «Ne e kuptojmë vetë se ku i kemi të metat tona dhe jemi vetë të zotët që t'i qortojmë dhe të mirësohemi shkallë-shkallë».<sup>1</sup> Pra, sipas saj, populli ynë nuk ka nevojë për mision «kulturor» të të huajve. Ne kemi nevojë të na lënë të qetë dhe populli ynë do të ecë i sigurt përpara. Gratë kanë besim se siç luftuan plot trimëri burrat në Luftën e Vlorës të vitit 1920, po kështu dhe gratë do të jenë në gjendje që të kapërcëjnë pengesat që u dalin për të marrë pjesë në këtë shoqëri përparimtare grash. «Nuk mbetet dyshim, që siç u rrëfyer burrat të zotët, sado që bota i quajtën të marrë, dhe çdo femër shqiptare pa i vënë veshin kritikave të njerëzve të pandërgjegjshëm do të lidhet me shoqet e saj për të forcuar shpresën që kombi ka në fuqinë e vet për kohën e ardhme.<sup>2</sup> Autorja e shkrimit fton gratë që të ecin kundër zakoneve prapanike po me atë guxim që shkuan burrat në betejë pa u shqetësuar për thashethemet e njerëzve të pandërgjegjshëm.

Po në numrin e parë të gazetës «Shpresa kombëtare» është botuar artikulli «Shkollë, shkollë!» shkruar nga e bija e Marigosë, Ferëniqi. Në vazhdim të idesë së rilindësve tanë të mëdhenj, në këtë artikull, si shkak

1) «Shpresa kombëtare», 6 shkurt 1921.

2) Po aty.

i të gjithë të këqijave quhet mungesa e kulturës, pa-dija, prandaj kërkohet që të hapen dhe të ndiqen sa më shumë shkollat. «Është e ditur se e gjithë kjo që vërejmë në kohërat e shkuara si ... shkelja e të huajve në tërë viset e Shqipërisë *ishin kosekuencat e padijes (nënvizimi im — Z.B.)*»<sup>1</sup>.

Një mbivlerësim i tillë i rolit të kulturës mendojmë se e ka bazën jo vetëm në kuptimin jo materialist që kishte ajo për këtë faktor të zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë njerëzore. Në artikull në mënyrë shkencore argumentohet arsyeja e kësaj përmbajtjeje «Për fat të keq në të gjitha Kombet e Ballkanit, kombi që ka jetuar mbrapa është kombi shqiptar. Jo se i mungon Jëshira dhe inteligjenca, por tirania e 500 vjetëve që e ndalonin mësimin e gjuhës amtare. Për këtë shkak ky i ngratë popull ka mbetur kaq mbrapa»<sup>2</sup>.

Duke i lidhur detyrat me gjendjen e re të krijuar pas vrasjes së Esat pashë Toptanit dhe sidomos me fitoren e Luftës së Vlorës artikullshkruesja vazhdon: «Prandaj lipset sot, që çeli fat i Shqipërisë, sot, viti 1920<sup>3</sup>, m'i shkëlqyeri dhe fatbardhi mot në jetën shqiptare, që i rrëfeu botës së qytetëruar me anën e të madhit Avni Rustemi dhe kryengritjen e Vlorës, që meriton të rrojë dhe duhet sot të përpiqemi me tërë fuqitë që të arrijmë dhe neve shkallën e kombeve të tjera e jo të rrimë mbrapa, siç kemi qenë sot e pesëqind vjet sepse dhe burrat tanë nuk janë më siç ishin në ato kohëra, por kanë vajtur shumë përpara.»<sup>4</sup>

Bija e Marigosë u bën thirrje shoqeve të ecin përpara «Sepse nga përparimi i femrës vjen edhe përparimi i përgjithshëm» dhe se këtë do të mundim ta bënin me përpjekjet e veta për arsimimin» «duke ndihmuar të gjitha shoqet tona që kanë këtë qëllim që të

1) «Shpresa kombëtare», 6 shkurt 1921.

2) Po aty.

3) Me sa duket, artikulli është shkruar në vitin 1920, por dritën e botimit e pa më vonë.

4) «Shpresa Kombëtare», 20 shkurt 1921.

mundin të dërgojnë vajza nëpër më të mirat shkolla të jashtme e kësisoj të përgatitin mësonjës të mbaruara. Atëherë, po, do të mundim të shohim që edhe ne do të rrojmë.»<sup>1</sup>

Duke i prekur në sedrën kombëtare, Fereniqi Posio kërkon që gratë shqiptare të përpiqen «Siç u përpoq gjithë bota, që t'arrin përndryshe na rroftë llafi i fantazirave».<sup>2</sup>

Një artikull tjetër redaktorial hedh dritë për nevojën e mësimin. Duke u nisur nga stili, na krijohet bindja se ai është shkruar nga Marigo Posio. Ajo e trajton këtë çështje në mënyrë të gjithanshme duke e quajtur zhvillimin mendor një detyrë me shumë rëndësi për njeriun. Në krye shkruhet: «Njeriu sot lipset të mendojë e të përkujdeset vetëm për ushqimin e trupit. Veç kësaj, detyrë ka edhe një tjetër, gjithnjë të madhe dhe me rëndësi, dhe kjo është zhvillimi dhe lëvrimi i mendjes».<sup>3</sup>

Në kundërshtim me ideologjinë e kohës kur dhuntitë e njeriut quheshin dhuratë e zotit, ajo pohon se natyra e ka pajisur njeriun me shumë të mira, i ka falur shumë lloj pasurish të njohura e të panjohura dhe bashkë me këto i ka dhënë edhe një vegël me një fuqi të veçantë (mendjen — Z.B.), që të dijë të nxjerrë prej saj fitime sa më të mëdha dhe për shfrytëzimin e tyre sa më të plotë për një jetë sa më të mirë e më të begatshme.

Duke e trajtuar zhvillimin mendor dhe mësimin si një armë të domosdoshme në duart e njeriut për të përmirësuar kushtet e jetesës së tij dhe të kombit. Mari-goja disi e idealizon këtë rol kur shkruan se në qoftë se një vend është më përpara se një vend tjetër në çdo pikëpamje, kjo vjen nga fuqia e mendjes, edhe me ndihmën e fuqisë së mendjes një njeri e një komb arrin jo vetëm përmirësimin ekonomik e të mëkëmburit

1) «Shpresa kombëtare», 6 shkurt 1921.

2) Po aty.

3) Po aty.

të shtetit të tij, por arrin të tërheqë kujdesin, simpatinë dhe dashurinë e të tjera, arrin të lartësojë nderin e vet në mes të shoqërisë njerëzore.

Ajo ngul këmbë se sa më e zhvilluar të jetë mendja e njeriut dhe e një kombi, sa më të çmuara e më të larta, të mira, e të lira, të jenë mendimet, aq më të fitimshme e më kuptimplote do të jetë jeta, se mendimet përbëjnë qytetërimin e përparimin dhe i japin frymë njerëzisë «e ndërrojnë menjëherë fytyrën e botës»<sup>1</sup>. E kemi të vështirë ta bëjmë fajtorë Marigonë pse ajo nuk e kuptoi dot në ato kushte, që fytyrën botës nuk ia ndërrojnë dot idetë, mendimet, por revolucionin shoqëror.

Atdhetarja Marigo Posio e kuptonte mirë se arsimi e kultura mund të merreshin në radhë të parë në shkolla, ndaj ajo e vlerëson lart këtë institucion të pazëvendësueshëm për jetën e një populli. Shqipëria në të kaluarën edhe ato pak shkolla që kishte i kishte në gjuhë të huaj; ndërsa tani ishin çelur disa shkolla fillore shqipe. Ajo e cilëson shkollën kombëtare një «ndërtesë qytetërie që ndrit mendjen e njeriut, ka në dorë përparimin e një kombi e të gjithë njerëzisë, rrezet që lëshon me anë të mësimin nuk lartësojnë vetëm mendjen, por vijnë e zbutim zemrat e njerëzve dhe i pajojnë me veti të vlejtura e të ndershme, e ushqejnë me virtyte të mira e të pëlqyera dhe për fuqinë e shëndetësinë e trupit.»<sup>2</sup>

Duke nxitur sedrën kombëtare për të çelur sa më shumë shkolla ajo shkruan se historia, mësonjësjë e jetës, na rrëfen se sa kombësi që përpara lëngonin në jetën e ndryshkur të padijes, sot e braktisën barbarinë mesjetare dhe janë vënë në udhë të tyre të re të qytetërimit, kanë arrirë në një shkallë të lartë të kulturës. E, megjithëkëtë, s'janë të kënaqur për përparimin që kanë bërë por përpiqen gjithnjë e pareshtur që t'i

---

1) «Shpresa kombëtare», 6 shkurt 1921.

2) Po aty.

tejkalojnë të tjerët në çdo fushë në mënyrë që t'i sigurojnë vetes dhe Atdheut një jetë sa më të mirë.

Megjithëse pavarësia u shpall, rrethanat e brendshme dhe të jashtme frenuan shumë zhvillimin e arsimit dhe të kulturës. Ajo vëren se mjerisht kombi ynë ende gjendet shumë poshtë nga ana e zhvillimit arsimor. Ajo ndihej e shqetësuar kur shikonte mjerimin dhe varfërinë që i kishte lënë këtij populli robëria e gjatë, por revoltohet se «këto mjerime me njëfarë mënyre po i heq edhe sot dhe gjithë këto mjerime vijnë nga mungesa e mësimi, e një mësimi të thjeshtë kombëtar».<sup>1</sup>

Notat e revoltës së saj vijnë e shtohen kur ajo shikon që klasat sunduese që ishin në krye të shtetit shqiptar nuk interesoheshin për zhvillimin arsimor të vendit. Ajo shtron pyetjen se si mund të justifikohet tani kjo gjendje e rëndë, arsimore e shkollore. Dhe thotë: «Po, atëherë asnjëri s'mund të na hidhte fajin neve, pse ishim prapa kombeve të tjera, pse gjendeshim në një shtet të egër. Por sot që vdiq errësira (lexo u zhdukën pushtuesit — Z.B.) dhe për vendin tonë sot retë u hapën që rrezet e një dielli të bukur e madhështor në ndritin viset e të dashurës Shqipëri, sot që liria e dëshiruar prej kaq kohe mbretëron dhe gëzon bijtë e bijat e saj, sot po them: Lipset të hedhin përtej rrobën e fanatizmit e të padijes dhe të shfaqim të gjallë dëshirën e mësimi, që të dëftehemi vërtetë një komb i zoti që të rrojë e të përparojë si të tjerët».<sup>2</sup>

Me interes të veçantë është ideja që ajo nuk kërkon mësim të çfarëdollojshëm, por një mësim që në radhë të parë t'u shërbejë interesave të Atdheut, kërkon një mësim të plotë të vërtetë.

Luftëtarja e madhe për emancipimin e gruas shqiptare, Marigoja nuk harron t'i kujtojë edhe qeverisë detyrat që asaj i dalin në këtë fushë si për djem ashtu edhe vajza.

«Për një mësim të plotë e të vërtetë kemi nevojë

1) «Shpresa kombëtare», 6 shkurt 1921.

2) Po aty.

të parë, të domosdoshme e kërkon Atdheu, e kërkon për sigurimin e jetës së vet, për përmirësimin e shtetit të tij, për të ngjallur e lartësuar çdo ideal. Këtë detyrë të domosdoshme lipset që Qeveria ta vështronte me kujdes të madh, si çdo Nëvojë t'atdheut, dhe për djem e për çupa, pse vetëm kësisoj ka për t'hyrë në udhën e qytetimit e të përparimit e se arma më e fortë për të shporrur të metat që ka lënë robëria e pesëqindvjetëve, shtylla më e fortë dhe më e sigurt është dituria dhe për femra si për burra (nënvizimi im — Z.B.).<sup>1</sup>

Shënon një hap të madh përpara për kohën kërkesa e saj që brezi i ri të marrë një arsim të shumanshëm dhe është e mendimit se për t'ia arritur këtij qëllimi duhet ndjekur një udhë e drejtë, «lipset që mësimet të mos përmbliidhen vetëm në lëvrimin e mendjes (edukatë mendore — Z.B.), duhet që të kenë në kujdes zhvillimin e zemrës (edukatën morale — Z.B.) dhe trupit (edukatën fizike — Z.B.), lipsen që në zemër të zgjohen ndjenjat e larta që t'i ngjallin vetijat e virtytet e shkëlqyera të fisit të saj (populli shqiptar — Z.B.), t'i ngjallet dëshira dhe vullneti për punë, t'i forcohet karakteri, t'i forcohet namustra (sedra — Z.B.) e saj e dëgjuar dhe përkujdesia e shëndetësisë së trupit.

Atëherë po, Shqipëria do përkëmbet e do të përparojë e do të nderohet, e do të jetë e lavdëruar ndë shoqe».<sup>2</sup>

Në gazetë nuk mungojnë dhe protesta me karakter thjesht politik, siç është mohimi i së drejtës së votës për gratë, i cili i privonte ato nga e drejta për të marrë pjesë në jetën politike të shoqërisë. Edhe në këtë rast protesta lidhet me nevojën e arsimit të vajzave. Nën titullin «Një çikë nga të gjitha» lexojmë: Në «Mbrotjtjen kombëtare, N. 17, këndojmë se kandidatët duan të përpiqen për shkolla për djem. Po vajzat nuk janë dhe ato pjesëtare të një kombësie?

1) «Shpresa kombëtare», 6 shkurt 1921.

2) Po aty, 20 shkurt 1921.

Sikur të ish që të votonin dhe gratë, mendoj se këta kandidatë nuk do të kishin asnjë votë nga të femrave.»<sup>1</sup>

«Shpresa kombëtare» nuk mund të mos vihej dhe në mbrojtje të të varfërve dhe të përbuzurve, në mbrojtje të atyre që rendi ekonomik-shoqëror në fuqi i kishte detyruar t'u shërbenin të pasurve sepse duhej të siguronin bukën e gojës. Ajo godet sidomos përdorimin e emrave që moralisht e poshtërojnë njeriun si thirrjet: SHEBEK, KOPILE.

«Nuk është gjë më e poshtër në botën njerëzore se të mbahemi dhe të sillemi madhështorisht (me mendjemadhësi — Z.B.) me të përvuajturit dhe të dëgjushmin»<sup>2</sup>.

«Shpresa kombëtare», sikurse dhe simotrat e saj, nuk arriti dot të kuptonte nevojën e zhvillimit të një lufte klasore për zhdukjen e pabarazisë shoqërore, por i kërkon këto të drejta mbi bazën e ideve iluministe, mbi bazën e lartësimit moral dhe mendor të njerëzve dhe jo mbi bazën e revolucionit shoqëror.

Në këtë organ gjejmë dhe shkrime me përmbajtje të shëndoshë materialiste dhe antifetare. Kështu, duke luftuar një mentalitet shumë të përhapur të kohës, se gjoja te njeriu gjithçka përcaktohet nga fati, artikullshkruesja i hedh poshtë këto thënie pa themel dhe pohon se lumturia, e ardhmja, përparimi dhe nderimi varen nga puna, vullneti dhe zgjuarësia e njeriut e nuk janë të përcaktuar aspak nga fataliteti. «Në ardhjet e mira të njeriut fatbardhësia hyn në atë masë sa të jetë mendja e prehur nga vullneti. Mund të themi pra që jemi neve ata që sjellim shkaqet e mira, të cilat na duken se na i sjell fati.»<sup>3</sup>

1) «Shpresa kombëtare», 3 prill 1921.

2) Po aty.

3) «Shpresa Kombëtare», 20 shkurt 1921.



b. Gjithë përparimi dhe zhvillimi i femrës t'i shërbejë lartësimit të Atdheut

Problem tjetër themelor që ngre gazeta «Shpresa kombëtare» është edhe ai i forcimit e lulëzimit të Atdheut. Edhe arsimimi dhe përparimi kulturor i femrës shqiptare në radhë të parë është shikuar në funksion të mbarëvajtjes së Atdheut, të shoqërisë dhe jo thjesht femrës si individ. Përparimi shoqëror e moral i saj është i lidhur pazgjidhshmërisht me të ardhmen e shtetit të ri, me të ardhmen e popullit.

Dashuria për mëmëdhenë lidhet në radhë të parë me luftën për të mbrojtur territoret shqiptare nga lakmitë imperialiste të shteteve fqinje, të cilat jo vetëm kishin pushtuar padrejtësisht toka të shumta shqiptare, por lakmonin dhe të tjera e po masakronin një pjesë të popullatës shqiptare. Gazeta sulmon «bishën e egër të Ballkanit, shovinistët serbë», të cilët «pa ndonjë të drejtë» kanë rrëmbyer «vendet e pasura unike të Dibrës e duke djegur katundet me një barbarizëm si hanët e vjetër» i kanë detyruar «dibranët e mjerë»<sup>1</sup> të braktisin shtëpitë.

Lufta kundër përçarjes dhe bashkimi i popullit të Vlorës pas fitores mbi imperialistët italianë ishte gjithashtu një problem tepër aktual. Pavarësia e qytetit ishte vënë në një luftë të etshme për të marrë kolltukun e prefektit. Në një mënyrë ose në një tjetër rreth pretendentëve filluan të grumbulloheshin dhe njerëzit e thjeshtë e të ndershëm, të cilët nuk e kuptonin rrezikshmërinë e kësaj përçarjeje. Kundër saj u sulën me furi Jani Minga, Murat Tërbaçi e të tjerë, të cilët që në vjeshtën e vitit 1920 botuan në gazetën «Mbrojtja kombëtare» artikuj të fuqishëm kundër këtyre veprimeve. Por lufta midis kolltukofagëve vazhonte ndaj dhe «Shpresa kombëtare» në një artikull redaktorial dënon përçarjen dhe kërkon bashkimin mo-

1) «Shpresa kombëtare», 20 shkurt 1921.



Marigo Posio



Marigoja me të shoqin, Jovanin.





Shtëpia e Jovan dhe Marigo Posios  
në Hoçisht (Korçë).



Shtëpia e Jovan dhe Marigo Posios  
në Vlorë (në fasadë është dhe pllaka  
përkujtimore).


Pushka dhe kasma të cilat mbaheshin në familjen e Marigo Poçit (Posios) për t'u mbrojtur nga xhandarët osmanë (në Korçë) në rast bastisjeje e arrestimi.



Kopje e flamurit të Shpalljes së Pavarësisë, qëndisur nga Marigo Posio dhe ngritur më 28 Nëntor 1912 nga Ismail Qemali. Ky flamur është vendosur në Shtëpinë-Muze të Pavarësisë në Vlorë.

Ndërtesa e shtëpisë së kulturës "Marigo Posio" në Hoçisht (Korçë).





nolit të popullit. Në këtë artikull të titulluar «Pse kundra?»<sup>1</sup> lexojmë:

«Ç'gëzonim dhe ëndërronim për kaq vjet, sot e fituam, sot e kemi atë gjë që vetëm në ëndërr ta shihnim se do të vërtetohet na dridheshin mishrat nga gëzimi, sot e shohim, e kemi në dorë. Vojtëm, u munduam, u robëtuam, u gjumëtuam dhe shpresën embajtëm të gjallë, nuk iu unjëm mjerimit dhe vojttjet i kapërcyem me trimëri, nuk ia bëmë ndonjëherë voljen (qejfin, dëshirën) armikut, as kur ishin në të mëdhatë rreziqe e mjerime dhe kësisoj me gjithë që mbase ishim pakicë fituam dhe ëndërrat tona u bënë të vërteta. Po të mos kishin qëndruar, siç them më sipër, ne sot do të ishim shkatërruar. Pra qëndruam kaq lartë në mes të mjerimeve e të bajonetave për një ideal, ç'lipset të bëjmë sot që të ketë ideal kaq të dëshiruar e shohim të vërtetuar?»

Marigoja u bën thirrje bashkëqytetarëve që të mos bien në pesimizëm, por të luftojnë që të zhdukin këto kundërshti, se ndryshe kjo do të dobësojë unitetin e kombit. Ajo kërkon që të ndreqen të metat dhe paudhësitë se ashtu e do nderi në hapat e parë të tij dhe këshillon popullin e atdhetarët që të mos tërhiqen mënjanë nga kjo luftë, por të kërkojnë që karrrieristët t'u japin fund këtyre dredhive sepse ato i sjellin dëme të mëdha mëmëdheut dhe bëjnë që armiqtë e jashtëm të përmbushin qëllimet e tyre.

Si njohëse e mirë e historisë së disa popujve të tjerë, ajo pohon se gjëra të tilla kanë ngjarë dhe tek ata në çastet e para të krijimit të shtetit të tyre të parvarur, por forcat e shëndosha kombëtare janë ngritur kundër veprimeve të tilla dhe nuk kanë lejuar të dëmtohen interesat e atdheut. Ajo kërkon që dëshpërimi të mos ketë vend në shpirtin e atdhetarëve, të cilët «lypset të vigjëlojnë, të ruajnë dhe të punojnë, se vetëiu nuk mund të vijë mirësia dhe se është turp e mëkat i madh që në Vlorën ku u kurorëzua ideali për

1) «Shpresa kombëtare», 20 mars 1921.

bashkim kombëtar, të fillojë përçarja. Mëmëdhetarja e shquar paralajmëron se bëmat e tyre u shërbejnë qëllimeve të bashkëpunëtorëve të Esat Toptanit dhe shkaktarëve të prishjes së Atdheut». Artikulli përfundon:

«Ata armiq që janë shkak i mjerimeve tona, sot po fërkojnë duart që na shohin të përçarë, edhe ne, të verbuar nga ekstremizmi, nuk duam të shohim ku vemi.

Për emërin e Atdheut, për vuajtjet që kemi pësuar, hapni sytë. Udhë që zutë është e gabuar. Në dëshironi shpëtimin e atdheut largohi nga udha që shqate (rrëshqet). Në bashkim, vetëm në bashkim do mundim të arrijmë atje ku dëshirojmë.»<sup>1</sup>

Gratë patriotike të Vlorës dhe shoqëria e tyre «Shpresa kombëtare» ngritën zërin e protestës dhe kundër veprimeve separatiste të një pjese të borgjezisë së qytetit të Korçës, të kryesuar nga Koço Kota, Thoma Orollogaj e të tjerë, të cilët i drejtuan qeverisë më 13 shkurt një memorandum me anën e të cilit «kërkohej që në Jug të Shqipërisë të krijohet një administratë e veçantë me parlament e legjislacion të vetin e me qendër në Korçë»<sup>2</sup>.

Në mbledhjen që u organizua nga shoqëria «Shpresa Kombëtare» më 10 mars 1921 u vendos të dërgohej një telegram kundër memorandumit të borgjezisë korçare. Ai i drejtohej Ministrisë së Brendshme si Katundarisë e Federatës «Vatra» të Korçës. Në të thuhej: «Të përkujdësura me shpresa të mira për të ardhmen e kombit tonë, neve, femrat përpiqemi për një bashkim, por ftohemi në shpirt kur dëgjojmë që në vend të bashkimit hapen përçarje të tjera.

Memorandumi i disa korçarëve është në kundërshtim me dëshirat tona dhe me parimet kombëtare të pranua-

1) «Shpresa kombëtare», 20 mars 1921.

2) «Historia e Shqipërisë», vëll. II, Tiranë 1965, f. 501.

ra nga të gjithë atdhetarët. Shoqëria e femrave «Shpresa kombëtare»<sup>1</sup>

Një vend të merituar zë në faqet e gazetës dhe krijimtaria poetike me temë atdhedashurie. Në këtë poezi spikat fryma e lartë atdhetare dhe popullore. Ato kanë subjekte të ndryshme, por i bashkon ideja e forcimit të mëmëdheut, e ecjes në rrugën e lirisë dhe të demokracisë.

Në këtë gazetë botohen edhe poezi të tjera me motive atdhetare. Një nga këto është ajo e Loni Logorit «Pranvera»<sup>2</sup> në të cilën alegorikisht i këndohet jo vetëm stinës së bukur, por të ardhmes së ndritur të mëmëdheut.

Optimizmi për të ardhmen e Shqipërisë dhe të gruas shqiptare shpërthen furishëm sidomos në poezinë «Gëzohu Shqipëri»<sup>3</sup> shkruar nga Urania, motra e Marigosë, e martuar në Tiranë.

Autorja është tepër e entuziazmuar kur shikon se me krijimin e shoqërisë patriotike të grave femrat do të mund të japin ndihmesën e tyre në paravajtjen e Shqipërisë:

*Shqipëri, ngjallu, o lulëzo!  
Çelu Shqipëri, se sot të erdhi dita;  
Gëzohu, qesh e ngjallu o jetë,  
kur dhe nga femrat lindi për ty drita.  
Po, lindi drita, lindi e agoj  
agoj e bukur jeta e lumturia,  
Mjergulla, errësirë u çduk e kaloj,  
Oh, shkrepë Shqipëri, fatbardhësia.  
S'ka ditë a natë që nuk kujtoj  
të ëndërroja nuk e besonja,  
se do të shifnija si po të shikoj,  
Kurrën e kurrës nuk e kujtonja.*

1) «Shpresa kombëtare». 20 shkurt 1921.

2) Po aty, 25 mars 1921.

3) Po aty, 6 mars 1921.



Pjesëmarrja e gruas në luftë për përparimin e At-dheut përshëndetet si një dukuri me vlerë të madhe për të ardhmen e Shqipërisë. Ajo vëren me gëzim se gratë shqiptare:

*kanë jo vetëm ndjenja, trimëri,  
por edhe pendën kapin si dijetare.*

Në këtë poezi i këndohet edhe njëres prej grave më të shquara në fushën e studimeve shqiptare Elena Gjيكës (Dora d'Istrias), e cila shkroi shumë për të bërë të njohur në Evropë Shqipërinë, atdheun e të parëve të saj. Duke shprehur nderim për figurën e saj të shquar, autorja e poezisë kërkon të lartësojë figurën e gruas shqiptare kur shkruan vargje të tilla:

*Dora D'istria e famshme, shoqe s'kish  
ish yll i madh e dill i diturisë,*

Autorja jep kushtrimin që gratë e vendit tonë «bijat e lirisë», t'i tregojnë botës se janë të afta edhe në fushën e diturisë:

*Përpara, pra, o grat e Arbërisë,  
Nëna e motra, bijat e lirisë,  
Le t'i kallëzojmë sot ne «Qytetnisë  
Q'e meritojmë faqen e historisë;  
Tash le të bindet gjithkush me ne  
Dhe le të njohë mirë Shqipërinë.  
Le të mejtojnë, le ta vënë re  
Gruan shqiptare, ç'vlen për diturinë.*

Për nevojën e bashkimit të popullit në gazetë botohet dhe një poezi 19 strofëshe që titullohet «Bashkimi»<sup>1</sup> firmosur nga R.A. Edhe në këtë krijim me përmbajtje të shëndoshë politike, por edhe me doza bestytnie, kërkohet forcimi i unitetit kombëtar.

Gazeta «Shpresa kombëtare» e koncepton dashu-

1) «Shpresa kombëtare», 20 mars 1921.

rinë dhe luftën për atdhe, si diçka që duhet të konkretizohet me veprimet dhe sjelljet e përditshme.

Në shkrimin «Si e duam mëmëdhenë» lexojmë: «Për të dashur mëmëdhenë me vepër të ndjenjës së vërtetë, lypset të apim neve, qytetarët, të tilla she-nibulla që të mos mund të na kuqin, por të na nderojnë. Po qe se një njeri përbuz të tjerët, mirësinë, nderin dhe thërret: Mëmëdheu, mëmëdheu, mos i beso. Ai është një mëmëdhetar i shtirë (hipokrit), është qytetas i dobët»<sup>1</sup>

Gazeta kërkon që gjithçka të bëhet, të tingëllojë kombëtare, të jetë e brumit shqiptar dhe paralajmëron se imitimi i të huajve është jo vetëm i padobishëm, por edhe i dëmshëm. Në të njëjtën kohë ajo afirmon idenë se duhet marrë nga të huajt ato që janë të mira.

Po në këtë artikull lexojmë: «Ne jemi të mendimit që t'imitojmë të huajt në pikëpamje të zhvillimit formal, që më tepër se e dobishme është e dëmshme për neve tue qenë që kemi ndryshim të madh në mes, sidomos në pikëpamje të zakoneve të qarkut të shtëpisë e të kapaciteve trashëguese, por të mos mbetemi edhe larg zhvillimit mendor. Ta pranojmë këtë të fundit, për me mujt me sigurie ngjallinë kombëtare.»<sup>2</sup>

Mbi bazën e dashurisë së pakufishme ndaj atdheut u frymëzua gjesti që kreu Avni Rustemi kundër tradhtarit Esat Pasha dhe mbi bazën e po kësaj dashurie u vlerësua vepra patriotike e këtij atdhetari të ri nga gratë e Vlorës. Ato jo vetëm që morën pjesë në mitingje e protesta që u organizuan në këtë qytet në kohën që gjykata franceze po e gjykonte atë, por ato i dërguan telegrame edhe disa gazetave të mëdha evropiane për të mos dënuar Avniun. «Sipas proponimit të kryetares Z. Marigo Posio u vendos dhe u pranua nga gjithë këshilla me gëzim të madh

1) «Shpresa kombëtare», 6 shkurt 1921.

2) Po aty, 6 shkurt 1921.

t'i bëhet një dhuratë nga ana e shoqërisë patriotit të madh Avni Rustemi si kujtim»<sup>1</sup>

c. Gruaja si bazë e familjes, edukatore e fëmijëve dhe amvisë e mirë

Gazeta «Shpresa kombëtare» nëpër faqet e saj hedh dritë dhe për një problem mjaft të rëndësishëm të kohës, për familjen e cila është një celulë bazë e shoqërisë njerëzore. Në të gërshetohen më së miri marrëdhëniet shpirtërore psikologjike me ato etiko-morale dhe ekonomike. Familja me të drejtë vlerësohet lart duke u quajtur: «Atdheu i zemrës». Në familje shkruan gazeta «një ëngjëll», që me shpirtëmadhësinë, fisnikërinë, dhe dashurinë bën që çdo gjë e zorshme të të duket e lehtë dhe çdo helm më pak i hidhur. Autorja shtron pyetjen retorike dhe përgjigjet «Po ky ëngjëll, cili është vallë? Ky ëngjëll është femra. A kini pyetur ndonjëherë vetveten cila është femra? Femra është nëna juaj, që ju adhuroni aq shumë, pa menduar se edhe ajo femër është.

Femra është motra juaj, që ju përpiqeni si e si ta lartësoni moralin dhe virtytet e saja, që të jetë e mbaruar dhe të ketë të ardhmen e saj të lumtur.

Femra është gruaja juaj, që ju kërkoni me aq përkujdesi e se doni të jetë ideale dhe e zgjuar për të qenë pastaj qeveritarja e shtëpisë suaj dhe ngushëllim në sëkëlldi dhe e përgatitur për të luftuar çdo mjerim që mund t'i vijë njeriut në këtë jetë.

Femra është bija juaj për të cilën juve bëni çdo therori që u tregon dashuria, e largoni nga çdo rrezik, sa hije të keqe s'lini t'i mbetet dhe s'dini si e si t'i ngjallni më të lartat ndjenja dhe mejtime, se e dëshironi të lartër dhe të shenjtë.

Këto, këto janë femrat.

1) «Shpresa kombëtare», 20 shkurt 1921.

Gjithë këto janë ato femra që u kanë mësuar dhe mbrojtur foshnjërinë tuaj dhe kanë gëzuar të ritë tuaj me një kuptim dashurie me dituri të plotë e me dëshirë të madhe.

Tani a është e drejtë që ky ëngjëll i familjes e vlefshme të jetë kaq prapa dhe pa kujdesim?»

Dhe autorja e shkrimit, bija e Marigosë, Fereniqi, u bën thirrje burrave «Juve që frerin e familjes e keni në dorë, juve që qeverisni... juve ju mbetet përgjigjja, përgjigjuni vetes suaj»<sup>1</sup>

Për vetë kushtet historike nëpër të cilat kishte kaluar vendi ynë, lirinë gruaja e kërkonte si dhuratë nga burri, gjë që dëshmon se ajo ishte ende larg vendit të veprimit aktiv shoqëror. Për t'ia arritur këtë qëllim duhej që të tërhiqeshin sa më gjerësisht masat e grave në veprimtarinë demokratike. Vetiu kështu do t'i shtohet asaj besimi që duhet të kishte në foreat e veta, por një arritje e tillë nuk ishte e lehtë. Kjo është arsyeja që vajza vlonjate pasi romantizon vlerën e nënës, motrës, gruas, bijës kërkon përkujdesje për «ëngjëllin» e shtëpisë nga prindi, vëllai, burri dhe kjo po ndodhte në kohën kur Halim Xhe- loja me shokë këmbëngulnin për çlirimin e gruas nga «zgjedha e keqe» dhe se «Nga kjo robëri duhet t'i shpëtojmë shoqet dhe motrat tona në është se duam një Shqipëri të re dhe evropiane»<sup>2</sup>

Ai u bënte thirrje grave: «Hidheni poshtë atë çarçaf që ndalon rrezet e përparimit dhe të qytetëri- mit dhe kërkoni të drejtat tuaja»<sup>3</sup>

Shoku Enver e ka paraqitur me një vërtetësi të rrallë gjendjen e mjerueshme të gruas sonë në të ka- luarën: «Vartësia ekonomike e gruas nga burri, e mbyllte gruan brenda katër mureve të shtëpisë dhe i njihte asaj vetëm funksionet si nënë, të lindte e të rriste fëmijë dhe pasandaj të bënte punët e shtëpisë,

1) «Shpresa kombëtare», 20 shkurt 1921.

2) «Mbrojtja kombëtare», 27 janar 1921.

3) Po aty.

t'i lante dhe t'i shtypte këmbët burrit, vjehrrit dhe vjehrrës dhe kur ajo nuk i pëlqente më burrit ose vjehrrës dhe vjehrrit burri e çonte gruan me një bohçe me plaçka te babai, duke i dërguar pas pusullën, siç thonë andej nga jugu, — d.m.th. ndarjen... Shumë herë nuk e ndante, por martohej edhe nja dy-tri herë të tjera, në mos më shumë, dhe e kthente shtëpinë në një harem skllavërie.»<sup>1</sup>

Mirërritja dhe miredukimi i vajzave përbën një objekt tjetër për gazetën «Shpresa kombëtare». Gazeta thekson se ato duhet të përgatiten si nëna dhe amvisa të mira për të ardhmen. Pasi tregohen shkaqet që e kanë lënë gruan shqiptare prapa në zhvillim, shtrohen disa detyra që duhet të plotësojë nëna kundrejt vajzës së saj.

Në artikullin «Detyrë e mëmës» mësojmë se të pakta janë ato nëna që i pleqërojnë punët dhe veprojnë si duhet ndaj vajzës së tyre që ajo të jetë e përgatitur për të hyrë në jetën e familjes së re dhe shprehet keqardhja që në jetën praktike shohim se nënat shqiptarka pasi të arrijë çupa në moshën e martesës përtypin në mendje ca idera të dyshimta.

Ngritja e problemit të komunikimit më të afërt nënë-bijë ishte një kërkesë e domosdoshme për kohën dhe shënonte një prirje drejt demokratizimit të familjes, në një shoqëri ku personaliteti i vajzës as që përfillej. Vajzave u qahet halli se nuk përgatiten për jetën ngaqë nuk u jepet mundësia për të vazhduar shkollën dhe se nga nëna nuk mësojnë gjësendi se ato vetë janë fare të paditura. Kjo sjell që të gjitha ëndrrat që ato thurin në vajzëri përfundojnë në helm, në një përrallë utopike.

Po cilat janë detyrat e nënës për vajzën për ta përgatitur për jetën familjare dhe etiko-morale? Autorja shkruan:

«a) Që t'i japin ushqim për rritjen lëndore (fizike — Z.B.) me atë dukësi shoqërore të pëlqyer.

1) Enver Hoxha, «Mbi problemin e gruas», 1967, f. 70-71.

b) Të mësojë që në vogëli shërbime më të unjëta shtëpiake për të larët, të arnuarat, të qepurat e të qëndisurat etj. Ajo femër që rri me duar n'ij dhe me duar kryq pret që bota t'ia bëjnë punët e burrat të ja blejnë në pjacë, nga ajo mos kij shpresë se do të rrjedhi nonjë e mirë.

c) T'i apin edukatën morale me urtësi e vërtetësi, me përunjësi, e me nderim të lartë, të thonë kurdoherë të drejtën dhe të mos vjedhin»<sup>1</sup>

Në këto kërkesa bien në sy dhe kufizimet ideore të kohës siç është përunjësia që kërkohet të edukohet te vajzat.

Autorja kërkon që vajzat të përgatiten në një mënyrë të tillë për jetën që të jenë vepruese dhe këshilluese të burrit dhe të ecin dorë për dorë me të derisa t'i ndajë forca e fundit e natyrës, vdekja. Artikulli përfundon «se emri i së mirës nuk vdes kurrë, as për vete, as për të parët e saj, që e rritën siç e do detyra prindërore.»<sup>2</sup>

Edukimi i vajzave shikohet në kuadrin e edukimit të përgjithshëm të brezit të ri, nga i cili varet e ardhmja e atdheut. Është mjaft i rëndësishëm fakti se në këtë drejtim mendimet e shprehura nëpër faqet e gazetës shënojnë një hap përpara në krahasim me mendimin pedagogjik të kohës, sidomos përsa i përket pjesëve përbërëse të edukimit dhe metodave të punës edukative.

Në kryeartikullin «Lumturia e atdheut», gazeta «Shpresa kombëtare» shkruan se në vendin tonë për shumë arsye fëmija s'ka mundur të marrë atë edukatë që duhet.

Si detyrë e parë e prindit, e sidomos e nënës, theksohet nevoja që të punohet me të gjitha forcat për të rritur fëmijë të shëndoshë e të fortë, t'u futet atyre në zemër ndjenja atdhetare dhe fisnike, të përpiqet me tërë fuqitë t'i ndreqë të metat që në foshnjëri, t'i

1) «Shpresa kombëtare», 20 shkurt 1921.

2) Po aty.

t'i lante dhe t'i shtypte këmbët burrit, vjehrrit dhe vjehrrës dhe kur ajo nuk i pëlqente më burrit ose vjehrrës dhe vjehrrit burri e çonte gruan me një bohçe me plaçka te babai, duke i dërguar pas pusullën, siç thonë andej nga jugu, — d.m.th. ndarjen... Shumë herë nuk e ndante, por marotohej edhe nja dy-tri herë të tjera, në mos më shumë, dhe e kthente shtëpinë në një harem skllavërie.»<sup>1</sup>

Mirërritja dhe miredukimi i vajzave përbën një objekt tjetër për gazetën «Shpresa kombëtare». Gazeta theksonte se ato duhet të përgatiten si nëna dhe amvisa të mira për të ardhmen. Pasi tregohen shkaqet që e kanë lënë gruan shqiptare prapa në zhvillim, shtrohen disa detyra që duhet të plotësojë nëna kundrejt vajzës së saj.

Në artikullin «Detyrë e mëmës» mësojmë se të paktën janë ato nëna që i pleqërojnë punët dhe veprojnë si duhet ndaj vajzës së tyre që ajo të jetë e përgatitur për të hyrë në jetën e familjes së re dhe shprehet keqardhja që në jetën praktike shohim se nënat shqiptarka pasi të arrijë çupa në moshën e martesës përtypin në mendje ca idera të dyshimta.

Ngritja e problemit të komunikimit më të afërt nënë-bijë ishte një kërkesë e domosdoshme për kohën dhe shënonte një prirje drejt demokratizimit të familjes, në një shoqëri ku personaliteti i vajzës as që përfillej. Vajzave u qahet halli se nuk përgatiten për jetën ngaqë nuk u jepet mundësia për të vazhduar shkollën dhe se nga nëna nuk mësojnë gjësendi se ato vetë janë fare të paditura. Kjo sjell që të gjitha ëndrrat që ato thurin në vajzëri përfundojnë në helm, në një përrallë utopike.

Po cilat janë detyrat e nënës për vajzën për ta përgatitur për jetën familjare dhe etiko-morale? Autorja shkruan:

«a) Që t'i japin ushqim për rritjen lëndore (fizike) — Z.B.) me atë dukësi shoqërore të pëlqyer.

1) Enver Hoxha, «Mbi problemin e gruas», 1967, f. 70-71.

b) Të mësojë që në vogëli shërbime më të unjëta shtëpiake për të larët, të arnuarat, të qepurat e të qëndisurat etj. Ajo femër që rri me duar n'ij dhe me duar kryq pret që bota t'ia bëjnë punët e burrat të ja blejnë në pjacë, nga ajo mos kij shpresë se do të rrjedhi nonjë e mirë.

c) T'i apin edukatën morale me urtësi e vërtetësi, me përunjësi, e me nderim të lartë, të thonë kurdoherë të drejtën dhe të mos vjedhin»<sup>1</sup>

Në këto kërkesa bien në sy dhe kufizimet ideore të kohës siç është përunjësia që kërkohet të edukohet te vajzat.

Autorja kërkon që vajzat të përgatiten në një mënyrë të tillë për jetën që të jenë vepruese dhe këshilluese të burrit dhe të ecin dorë për dore me të derisa t'i ndajë forca e fundit e natyrës, vdekja. Artikulli përfundon «se emri i së mirës nuk vdes kurrë, as për vete, as për të parët e saj, që e rritën siç e do detyra prindërore.»<sup>2</sup>

Edukimi i vajzave shikohet në kuadrin e edukimit të përgjithshëm të brezit të ri, nga i cili varet e ardhmja e atdheut. Është mjaft i rëndësishëm fakti se në këtë drejtim mendimet e shprehura nëpër faqet e gazetës shënojnë një hap përpara në krahasim me mendimin pedagogjik të kohës, sidomos përsa i përket pjesëve përbërëse të edukimit dhe metodave të punës edukative.

Në kryeartikullin «Lumturia e atdheut», gazeta «Shpresa kombëtare» shkruan se në vendin tonë për shumë arsye fëmija s'ka mundur të marrë atë edukatë që duhet.

Si detyrë e parë e prindit, e sidomos e nënës, theksohet nevoja që të punohet me të gjitha forcat për të rritur fëmijë të shëndoshë e të fortë, t'u futet atyre në zemër ndjenja atdhetare dhe fisnike, të përpiqet me tërë fuqitë t'i ndreqë të metat që në foshnjëri, t'i

1) «Shpresa kombëtare», 20 shkurt 1921.

2) Po aty.



bëhet sjellja e mirë një natyrë e dytë, që të mos i japë lejë kurrë që të gënjejë, ta mësojë që të ketë zët dembellëkun, se dembellëku është nënë e të gjitha ligësive, ta përgatisë për në shkollë dhe për të prindi të mos kursejë gjë.

Edukimi duhet ta bëjë njeriun të vlefshëm për shoqërinë dhe mëmëdheun. Marigoja shkruante se shëndeti, dashuria, ndjenjat e larta njerëzore që duhet t'ia japin prindërit fëmijës do të jenë pasuria më e mirë dhe paja më e bukur. «Këto dhe vetëm këto kanë për ta bërë të lumtur dhe të vlefshëm këtë njeri për njerëzinë e për atdheun. Dhe atëherë do të thuhet se prindi e mbaroi siç duhet detyrën e tij.

*Detyra më e madhe që kemi është detyra që kemi përpara fëmijës»<sup>1</sup>, vazhdon artikulli (nënvizimi im — Z.B.).*

Prapambetjen kulturore të brezit të ri, autorja e shpjegon me faktin se prindërit tanë s'kanë patur mundësi dhe jo se nuk kanë dashur t'i përgatisin fëmijët ashtu siç duhet për jetën.

Duke e vlerësuar brezin e ri si forcën më përparimtare të së ardhmes së atdheut, autorja shkruan se shpresat më të mëdha janë te fëmijët dhe se te ata duhet të hidhet i gjithë kujdesi, tërë mendimet. Kërkohej që prindi ta kryejë sa më mirë këtë detyrë të shenjtë, se *Atdheu dhe gjithë njerëzia te fëmijët e kanë shpresën* (nënvizimi im — Z.B.). Fëmijët lipset të kenë tërë dashurinë e prindërve dhe tërë ndihmën e tyre.

Artikullshkruesja e tepron kur thotë se prindi vetëm për fëmijën «duhet të mendojë në këtë botë», por ka të drejtë kur shprehet se «barra e madhe që i ngarkohet prindit nga shoqëria e sotme është shumë e lartë, shumë e madhe. Për ta mbajtur siç duhet këtë barrë të madhe» prindi lipset ta hedhë tej egoizmin e tij se vetëm kështoj do mund të përmbushë veprën e nevojshme që i kërkon njerëzia.»<sup>2</sup>

1) «Shpresa kombëtare», 6 mars 1921.

2) Po aty.

Për mirërritjen e fëmijëve gazeta boton dhe përvoja nga vende të zhvilluara të marra kryesisht nga shtypi përparimtar shqiptar i kohës.

Artikujt janë të atillë që hedhin dritë për një sërë gështjesh me karakter të mprehtë shoqëror dhe familjar, duke synuar që të luftojnë të vjetrën dhe t'i hapin rrugë së resë. Në një nga artikujt e marrë nga gazeta «Dielli», midis të tjerash, shkruhet: «martesa në Gjermani nuk varet nga pasuria, por nga lidhja e zemrës midis bashkëshortëve. Vajza pa frikë lidh jetën e saj me njeriun që do dhe mund të presë një sërë vjetësh gjersa ai të jetë i zoti të fitojë mjetet e duhura për mbajtjen e familjes së tij. Martesa e fut atë në një kategori tjetër shoqërore dhe e bën të dalë përpara me tërë shkëlqimin e saj. Ajo di si të shfaqë nderin dhe dashurinë ndaj burrit të saj, e në vend që t'i shtojë huqet atij, ajo ia largon e ia zhduk. Ajo është mikja e tij e besës, këshillonjësja në orën e keqe, besnike e të shoqit».

Të propagandoje mendime për dashurinë dhe për marrëdhëniet bashkëshortore, siç bënte ky organ, do të thoshte që të bëje një hap të madh përpara, të ftoje vajzën dhe gruan shqiptare për më shumë të drejta shoqërore.

Duke trajtuar detyrat e reja që kryen gruaja-nënë ndaj fëmijës dhe atdheut në një artikull të marrë nga gazeta «Dielli» thuhet: «Mëma, që pa nisur të fjalosë foshnja, i këndon këngë si të dojë dhe të nderojë Atdheun, prindërit dhe begatinë. Pasi rritet pak i tregon turli historirash të bukura të jetës së saj dhe kurrrë si thotë për ndonjë të ligë, qoftë edhe për të qeshur. Dëshira më e madhe e saj është që të rrijë pranë fëmijës dhe t'i mësojë atij. Për atë vetëm mendon, ëndërron dhe kujdeset. Ajo është dhe mësonjëse. Nëna e mirë rrit moralin e qytetarit të ndershëm, i cili pastaj ia di vlerën atdheut»<sup>1</sup>

Për ndihmën e madhe dhe të pazëvendësueshme që

1) «Shpresa kombëtare», 6 mars 1921.

i jep nëna në shtëpi familjes lexojmë: «Sado mësonjës të mirë të ketë një komb, nuk mund të civilizohet pa mos dhënë ndihmën nëna, të metat nuk hiqen, rrënjosen që në vogëli dhe duhen shkukur që në atë kohë dhe këtë punë kaq të çmuar ta mbarojë vetëm nëna».<sup>1</sup>

Për rolin dhe rëndësinë që ka nëna në jetën e familjes dhe në edukimin e tërë anëtarëve të saj në artikullin redaktorial «Mëmave shqiptarka» lexojmë se nëna është mjeshtre e shtëpisë dhe duhet të marrë masat e duhura për ta qeverisur atë siç duhet. Ajo duhet të dijë si të krijojë një burrë ideal dhe një djalë të përsosur, me zakone të larta. Po ashtu kjo duhet të edukojë edhe një vajzë të talentuar siç e kërkon koha. Asaj duhet t'i mësojë dhe punërat shtëpiake. Këtë edukatë duhet ta marrë në familje. Tërë zakonet që i përkasin një personi si në të veshur, në karakter dhe në shpirt i detyrohen nënës dhe ajo duhet t'ua ngulisë fëmijëve këto gjëra në kohën e duhur. Autorja, që bindemi se është Marigoja, pyet:

— A nuk është e vërtetë që një djalë ose një vajzë që është e sjellshme me prindërit dhe me njerëzit e shtëpisë e tillë do të jetë gjithashtu edhe me të tjerët?

Marigoja duke vlerësuar lart edukatën familjare nuk mohon në të njëjtën kohë dhe ato norma të sjelljes dhe të veprimtarisë që brezi i ri merr me anën e librave. Ajo e quan gabim të madh të mendojë se një vajzë ose një djalë mundet të marrë mësimet e sjelljeve vetëm prej librave, që janë shumë të dobishëm për të zgjeruar fushën e arsimit të tyre, po në radhë të parë edukata është detyrë e nënës.

Duke patur parasysh dhe nivelin e pamjaftueshëm të njohjes së një sërë rregullash të mirësjelljes nga gratë, autorja jep disa porosi konkrete për këto çështje:

«A është e arsyeshme dhe për ç'nevojë një djalë të mbajë veshur festen kur qëndron përpara prindërve duke folur, ose kur ndodhet brenda në shtëpi dhe

1) «Shpresa kombëtare», 6 mars 1921.

ndërmjet zonjash? A është e arsyeshme që të hyjë ndërmjet dy të tjerëve dhe t'u presë bashkëfjalimin. A është e pëlqyeshme që të hyjë në shtëpi me këpucë të ndotura. A është e drejtë për një djalë që të lihet pa qortuar kur flet fjalë të liga kundra shokëve të tij dhe a është e arsyeshme që të kritikojë ushqimet e gatuarat për ngrënie nga nëna? Tërë këto zakone i detyrohen mëmës që t'ia predikojë përditë dhe me shumë kujdes fëmijëve të saj para se të arrijnë në moshën që do të jetë zor që t'ja mësojë. Po kur mëma të mbarojë tërë këto detyra, nuk është detyrë e të atit që të përgëzonjë dhe të lëvdojë të tillë mëmë, duke e përkrahur atë e cila, jo vetëm që fatbardhëson jetën e tyre, por fatbardhëson dhe zakonet e kombit? Kombi ynë këto zakone aq të çmuara i kërkon prej mëmës shqiptare, pra le të zgjohen mëmat e reja të Shqipërisë!».

Mirërritja e fëmijëve dhe mbarëvajtja e familjes është e lidhur dhe me kryerjen sa më mirë nga ana e nënës të detyrës së saj si amvisë, si organizatore e ekonomisë shtëpiake, ndaj «Shpresa kombëtare», si organ i grave, boton materiale për një organizim sa më të mirë të punës, sidomos propagandon rëndësinë e madhe që ka ekonomia shtëpiake për jetën e një familjeje. Një gjë e tillë kërkohet t'u mësohet vajzave të reja «për të cilat ekonomia shtëpiake është një udhëheqës i çmueshëm, sepse stërvit të çmojnë atë gjë që e dëshirojnë ta dinë e që është nevojë ta zbatojnë në jetën praktike.»<sup>2</sup>

Si në çdo rast edhe për këto probleme që, në shikimin e parë duken thjesht si detyra të gruas brenda mureve të shtëpisë, vlerësohet kombëtarja, patriotikja dhe mendimet që kanë dhënë për këtë punë rilindësit tanë të mëdhenj. «Gruaja nikoqire ose amviseja, si thotë dritë pastë Kristoforidhi, përngjan si një ajo lule e këndshme që gjendet midis kopshtit e mbulueme nën

1) «Shpresa kombëtare,» 25 maj 1921.

2) Po aty.

fletët e pemëve e shpërndan s'andejmi gjithkund erën e saj të kundërmueshme prej së cilës freskohet e përngjallet gjithë kopshti me pemët e tjera.

Kopshti është shtëpia e pemët janë familja që rrojnë në shtëpi. Influenca e gruas brenda një familje duhet të përhapet ngadalas e harmonisht pa bujë e pa brohori.»<sup>1</sup>

Për t'u ardhur në ndihmë sa më mirë grave gazeta boton dhe materiale praktike për mënyrat e disa lloj gatimeve dhe sendesh ekonomie shtëpiake, si përgatitja e sapunit etj., si dhe jep këshilla mjekësore për t'u mbrojtur nga rreziku i disa sëmundjeve e si mund të kurohen praktikisht prej tyre.

d. «Shpresa kombëtare» — organizatore e grave  
shqiptare

Shoqëria «Shpresa kombëtare» dhe organi i saj bëjnë një luftë mjaft të madhe për organizimin e grave të Vlorës në këtë shoqëri. Në fillim synimi i saj ishte mirëbërës dhe gradualisht mori një profil gjithnjë e më të theksuar patriotiko-politik dhe kulturoro-emanecipues.

Kjo shoqëri atdhetare grash u formua më 10 maj 1914 në qytetin e Vlorës<sup>2</sup>, «nga ngjarjet anormale në dhenë tonë, që e mbetur në gjumë, deri më sot.»<sup>3</sup>

Me shporrjen e pushtuesit italian shumë gra të qytetit «të përkujdesura për nevojat e mëmëdheut dhe të kohës, për krahun e nevojshëm të femrës në lartësimin e reformave kombëtare, shoqërore e shtëpiake mori fillesën e ngjalli programin e duhur duke bashkuar të gjitha femrat në qarkun e shoqërisë «Shpresa kombëtare.»<sup>4</sup>

1) «Shpresa kombëtare», 25 maj 1921.

2) Po aty, 6 shkurt 1921.

3) Mbrojtja kombëtare», 27 janar 1921.

4) Po aty, 27 janar 1921.

Ndërsa vetë gazeta «Shpresa kombëtare», duke shkruar për historikun e krijimit të shoqërisë, pohon se ajo u formua «për ndihmën e luftëtarëve të Shqipërisë Jugore për të ikurit e asaj kohe nga ato vise»<sup>1</sup> dhe se me përpjekjen e madhe të shoqeve u arrit të mblidheshin «mjaft ndihma për luftëtarët, muhamexhirët dhe smutoret (spitalet) e Vlorës»<sup>2</sup>.

Dhe më poshtë nënvizohet fakti se po të mos kishin ardhur kohë të turbullta, «që atëherë shoqëria do të kish ndruar program me një ndryshim të dobishëm (nënvizimi im — Z.B.)».

Për së dyti «Shpresa kombëtare» po ngjallet dhe me kanonizim shoqërorë po përmbledh në gjiun e saj të gjithë zonjat, (lexo gratë — Z.B.) të gjitha nënat e qytetit tonë».<sup>3</sup>

Shoqëria «Shpresa kombëtare», pra, ishte një shoqëri e gjerë që pranonte në gjirin e saj të gjitha gratë, pavarësisht nga formimi i tyre kulturor apo arsimor. E parë në këtë kënd, ajo ishte mjaft përparimtare se përfshinte brenda dhe gratë e shtresave të varfëra, të cilat përbënin shumicën dërrmuese të grave të qytetit të Vlorës, e që më parë as që përfillehin.

Një shtytje të madhe i dhanë shoqërisë gratë e patriotëve të shquar që ishin anëtarë të saj. Ato fushin frymën patriotike të tyre në radhët e kësaj shoqërie. Të tilla mund të përmendim: gruaaja e ish-kryeministrit, Sulejman Delvinës, ajo e Jani Mingës, Halim Xhelos, Hamza Isait, Murat Tërbaçit, Abaz Mezinit, Ali Asllanit etj.

Format demokratike të organizimit duken dhe në faktin se ajo administrohej prej një këshille prej 12 vetash, të cilat zgjidheshin nga mbledhja e përgjithshme me një afat njëvjeçar. Këshilli përbëhej prej kryetares, nënkryetares, arketares dhe shkronjëses (sekretareshes), ndërsa të tjerat ishin këshilltare.

Mbledhja e përgjithshme në bazë të rregullores, që

---

1) «Shpresa kombëtare», 6 shkurt 1921.

2) Po aty.

3) Po aty.

përfshihet nën emrin «Programi i shoqërisë» bëhej çdo muaj dhe kur qe nevoja dhe më shpesh, ndërsa këshilli mbledhej çdo dy javë dhe bënte raportet tremujore. Përcaktoheshin dhe detyrat e arkëtares dhe të sekretares.

I rëndësishëm është fakti që programi «mund të ndërrohej pas nevojës, por kurrë nuk mund të ndryshohej qëllimi i saj».<sup>1</sup>

Shoqëria «Shpresa kombëtare» dhe organi i saj shërbyen për organizimin e grave të Vlorës, fillimisht, por rrezet e saj shumë shpejt u shpërndanë në të katër anët e Atdheut.

Që në numrin e parë «Shpresa kombëtare» përshëndet gratë në Shkodër, në Tiranë, në Korçë e në Gjirokastrë dhe i falenderon ato «për shkrimet dhe vjershat» që kanë dërguar, «se «propaganda në femra... është reformë e mirë kombëtare» dhe përgëzon sidomos ato gra «që dëshirojnë të bëhen anëtare të shoqërisë».<sup>2</sup> Pra, luftohej që të krijohesh një shoqëri femrash gjithëkombëtare, ose të paktën të kishte degët apo veprimtarët e saj në disa nga viset kryesore të vendit.

Në këto përshëndetje vlerësohet lart vepra atdeshëse e grave të Vlorës, «Pra nder e lavdi zonjave të Vlorës kreshnike e sidomos iniciatoreve që për herë të parë e çmuan këtë të metë edhe hodhën gurin e parë në themelet e Shoqërisë së femrave në Shqipëri tue rrëfye kështu se janë me të vërtetë shoqet, bijat e motrat e atyre burrave vlonjatë, që kurdoherë janë rrëfyer të parët në fushë të patriotizmit».<sup>3</sup>

Dalja e gazetës «Shpresa kombëtare» u përshëndet dhe nga organe të tjera të shtypit shqiptar. Për të lexojmë: «Prej dy numrave të parë, që na kanë ra gjer më sot në dorë duket vullneti i mirë, kompetenca e shkrimtarëve, e prandaj për motrës sonë të re i urojmë jetë të gjatë për Dobie të Atdheut».<sup>4</sup>

1) «Shpresa kombëtare», 6 shkurt 1921.

2) Po aty.

3) Po aty, 6 mars 1921.

4) «Gruaja shqiptare», 5 mars 1921.

Shoqëria «Shpresa kombëtare» dhe organi i saj vënë një nga gurët e parë në themelet e organizimit të grave shqiptare, të cilave regjimet e kohës u kishin mohuar të drejtat më elementare.

Duke dashur të ngrerë lart nevojën e organizimit të gruas «Shpresa kombëtare» boton artikuj dhe për organizimin e grave në vende të tjera të botës duke treguar rolin e madh që ato kanë luajtur në emancipimin e gruas. Në gazetë shprehet bindja dhe për të ardhmen e ndritur të grave shqiptare, gjë që u bë realitet vetëm pas Çlirimit të atdheut. «A do të arrijë, thashë me mendjen time, që edhe gruaja shqiptare të zërë një të këtillë shkallë?... dhe përnjëherësh solla ndër ment Elena Gjickën, atë shqiptare, e cila nën emrin letrar Dora d'Istria, habiti tërë botën e qytetëruar me shkrimet e saj, të cilat nderohen nga të gjithë ata që janë të zotërit t'i gjykojnë.

Ky mejtim, — pohon autorja, — më dha përnjëherësh shpresë dhe kjo shpresë m'u madhua më shumë kur solla ndërment «Shpresën kombëtare» që do të realizojë një ditë dëshirën që ka çdo shqiptar përparimdashës».<sup>1</sup>

Një mësuese e atyre viteve, Vasiliqi Naka, tregon: «Ne e prisnim me padurim daljen e çdo numri të kësaj gazete dhe se jo vetëm mësueset, por dhe ato gra që dinin shkrim e këndim ua lexonin artikujt e saj grave dhe vajzave analfabete. Ato ndienin një kënaqësi të veçantë kur shikonin se ajo mbronte të drejtat e femrës dhe u mësonte atyre shumë gjëra të reja. Kjo gazetë na ngjallte shpresa më të mira për të ardhmen e atdheut dhe të gruas shqiptare. Kur pamë se ky organ nuk do të botohej më, u pikëlluam sa s'bëhet»<sup>2</sup>

---

1) «Shpresa kombëtare», 6 mars 1921.

2) Kujtime dhënë autorit.



#### 4. Disa mendime rreth pikëpamjeve politiko-shoqërore të Marigosë

Në historinë e mendimit politiko-shoqëror shqiptar të çerekut të parë të shekullit tonë Marigo Posio zë një vend nderi duke u bërë një nga përfaqësueset më të denja të femrës shqiptare. Mendimet e saj janë pikëpamjet e përparuara të kohës, vazhdim i mendimit më të përparuar të Rilindjes Kombëtare.

Marigoja jetoi me problemet dhe shqetësimet e kombit dhe të popullit shqiptar, mendimet e saj ishin shprehje e aspiratave më të ndritura të masave popullore. Në shkrimet e saj të botuara gjatë Rilindjes dhe Pavarësisë, preken plagët më të rënda të shoqërisë shqiptare duke kërkuar zgjidhjen nga pozita sa më të përparuara. Për këtë arsye, mendimet e saj, sikurse dhe të atdhetarëve të tjerë bashkëkohës, lëshuan rrënjë të thella në mendjet dhe zemrat e popullit, sidomos të grave, duke dhënë një ndihmesë të mirë në rrugën e «Paraecjes» së kombit dhe të femrës shqiptare.

E edukuar me idetë iluministe të rilindësve tanë, Marigoja si shkak kryesor dhe forcë lëvizëse për përparimin e shoqërisë quan përsosjen e fuqive mendore të njerëzve dhe shtimin e dijeve të tyre. Ajo mendonte se arsimi dhe edukata luajnë rolin kryesor në zhvillimin e shoqërisë.

Pikëpamjet iluministe të Marigo Posios ishin një hap i rëndësishëm përpara dhe një goditje e fortë kundër pikëpamjeve mistiko-fetare.

Kuptim të drejtë kishte Marigoja dhe për rolin e masës dhe të individit në zhvillimin e shoqërisë. Ajo e kuptonte se masat popullore po të ishin të bashkuara ishin në gjendje të realizonin aspiratat e tyre. Kjo është arsyeja që ajo u bën thirrje atyre për t'u bashkuar kundër pushtuesit të huaj duke forcuar njësimin kombëtar. Duke vlerësuar rolin e masës ajo nuk e zbeh aspak rëndësinë e individit. Kur ai shkrihet me masën, qëndron në ballë të luftës për realizimin e

ideve të saj. Poezia kushtuar Avni Rustemit dëshmon qartë për këtë.

Marigo Posio është kundër pushtimit të tokave të huaja. Ajo lavdëron luftën heroike të popujve të vegjël për t'i shpëtuar sundimit të huaj, siç ishin luftërat e drejta të popullit tonë kundër osmanllinjve, shovinistëve fqinjë dhe imperialistëve italianë. Ajo i quan luftërat e padrejta antinjerëzore dhe ngre lart luftërat çlirimtare duke pohuar se nuk duhet të ketë gjë më të shtrenjtë se atdheu. Ajo dënon luftërat grabitqare, por nuk arriti dot të kuptojë shkaqet e tyre të vërteta.

Marigoja, si shumë adhetarë të shquar, dënon edhe ndarjen e shoqërisë në të pasur dhe në të varfër, në njerëz që punojnë dhe në të atillë që rrojnë në kurriz të të tjerëve, por meqë nuk arrin dot të kuptojë shkakun e kësaj ndarjeje, që lidhet me disa faza të caktuara historike të zhvillimit të prodhimit, ajo e redukton protestën në kritikën ndaj atyre që sillen keq me të varfërit, shërbëtorët dhe shërbëtoret e tyre. Ajo i quan të dëmshme parazitët dhe urren e shprehet ashpër kundër kopracëve, të cilët shikonin vetëm interesin e tyre dhe nuk shqetësoheshin aspak për bashkatdhetarët që vuanin, siç ishte rasti i muhaxhirëve të dëbuar nga tokat e tyre prej shovinistëve grekë, serbë e malazezë.

Duke kritikuar parazitët Marigoja shprehet edhe kundër fatalizmit që predikohej me aq zell nga klerikët dhe pohon se fatin e njeriut e vendos vetë ai me punën e tij.

Marigoja çmoi dhe vlerësoi lart traditat fisnike të popullit tonë, tradita e virtyte që duheshin ruajtur dhe zhvilluar, por ajo në të njëjtën kohë vlerëson edhe zakonet e traditat e popujve të tjerë.

Për të përfituar nga kultura e vendeve të tjera Marigoja quan të nevojshme njohjen me kulturën e tyre, e cilëson si një virtyt të mirë të shqiptarëve mësimin e gjuhëve të huaja.

Cilësimi nga shtypi i kohës si gruaja më e ditur e qytetit jo vetëm që nuk ia rriste mendjen, por e

bënte atë si një model të thjeshtësisë midis grave të thjeshta vlonjate. Thjeshtësinë dhe mirësjelljen ajo e quan si një virtyt të njeriut të kulturuar dhe bën të gjitha përpjekjet që këtë tipar ta edukojë te fëmijët e saj, vajzat dhe gratë vlonjate.

Këto mendime të fushës politiko-shoqërore dhe sidomos veprimtaria e saj në fushën e emancipimit të femrës ushtruan një ndikim mjaft pozitiv në zgjimin e fuqive të ndrydhura të vajzave dhe grave shqiptare.

Për luftën e madhe që bëri ajo për çlirimin kombëtar e shoqëror Presidiumi i Kuvendit Popullor me dekret nr. 3037, datë 7.3.1960, e ka dekoruar Marigo Pasion me Urdhrin e Lirisë të Klasit të dytë me këtë motivacion: «Ka punuar pa u lodhur për përhapjen e gjuhës shqipe, çlirimin dhe emancipimin e gruas shqiptare, duke përjetësuar kështu traditat e lavdishme të grave shqiptare».

## PËRMBAJTJA

### Kreu I.

1. Mjedisi atdhetar i viteve të fëmijërisë dhe të rinisë .....	3
2. Luftëtarë për lirinë e Shqipërisë .....	9
3. Marigoja dhe çështja e flamurit kombëtar .....	18
4. Gjithë familja Posio në shërbim të Atdheut dhe të përparimit .....	23
5. Krijuese e organizatës së parë të grave vlonjate dhe shpëtimtare e jetës së shumë refugjatëve .....	27
6. Veprimtare për çlirimin e Vlorës dhe mbrojtjen e Avniut .....	32
7. E përçmuar nga regjimi, e dashur për popullin .....	39

### Kreu II. KRIJIMTARIA PUBLICISTIKE E MARIGO POSIOS .....

43

1. Mendime për shkollën, mësuesin dhe gjuhën shqipe .....	44
2. Bashkimi i popullit — çelësi i artë i të gjitha fitoreve ....	50
3. Gazeta «Shpresa kombëtare» .....	52
a) Përmbajtja dhe qëllimi i gazetës. ....	52
b. Gjithë përparimi dhe zhvillimi i femrës t'i shërbejë lartësismit të Atdheut .....	64
c. Gruaja si bazë e familjes, edukatore e fëmijëve dhe amvisë e mirë .....	70
d. «Shpresa kombëtare» — organizatore e grave shqiptare ....	78
4. Disa mendime rreth pikëpamjeve politiko-shoqërore të Marigosë .....	82

APPENDIX

1  
2  
3  
4  
5  
6  
7  
8  
9  
10  
11  
12  
13  
14  
15  
16  
17  
18  
19  
20  
21  
22  
23  
24  
25  
26  
27  
28  
29  
30  
31  
32  
33  
34  
35  
36  
37  
38  
39  
40  
41  
42  
43  
44  
45  
46  
47  
48  
49  
50  
51  
52  
53  
54  
55  
56  
57  
58  
59  
60  
61  
62  
63  
64  
65  
66  
67  
68  
69  
70  
71  
72  
73  
74  
75  
76  
77  
78  
79  
80  
81  
82  
83  
84  
85  
86  
87  
88  
89  
90  
91  
92  
93  
94  
95  
96  
97  
98  
99  
100



Tirazhi: 2000 kopje      Formati 78x109/32      Stash: 2204-82

---

KOMBINATI POLIGRAFIK      «Shtypshkronja e Re»  
Tiranë 1990.